



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 697 Akti

Nr. 425 Vendimi
Tiranë, më 21.7.2021

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Valbona Sanxhaktari
Firdes Shuli
Olsi Komici

Kryesuese
Relator
Anëtar

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Orianda Lici, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Francesco Ciardi, në datat 8.7.2021, 15.7.2021 dhe 21.7.2021, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Arben Smaçi**, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenet A, Ç, D, DH, E dhe Ë të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;**

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, znj. Firdes Shuli, mori në shqyrtim çdo provë dhe dokument të vënë në dispozicion nga organet kompetente ligjore, shpjegimet dhe provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, përfundoi procesin e rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit Arben Smaçi, i cili në seancë dëgjimore publike kërkoi konfirmimin në detyrë, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Z. Arben Smaçi, është subjekt i rivlerësimit për shkak të funksionit të tij si prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, bazuar në nenin 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim ligji nr. 84/2016).

2. Bazuar në pikën 2, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin të Pavarur të Kualifikimit”, është zhvilluar shorti në datën 15.12.2020, në përfundim të të cilit rezultoi që subjekti i rivlerësimit Arben Smaçi do t’i nënshtrohej procesit të rivlerësimit, nga trupi gjykues i përbërë nga komisionerët Valbona Sanxhaktari, Firdes Shuli dhe Olsi Komici. Relatore e çështjes u zgjodh me short komisionere Firdes Shuli.

3. Për këtë subjekt rivlerësimi u administruan raportet e vlerësimit të hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI), sipas neneve 31 - 33, të ligjit nr. 84/2016; Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK), sipas neneve 34 - 39, të ligjit nr. 84/2016; dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim KLP), sipas neneve 40 - 44, të ligjit nr. 84/2016.

4. Me vendimin nr. 1, datë 15.1.2021, trupi gjykues vendosi të fillojë hetimin administrativ, sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit të subjektit Arben Smaçi, duke u bazuar në të tria kriteret e rivlerësimit, si dhe të caktojë kryesuesin e trupit gjykues, komisioneren Valbona Sanxhaktari. Të gjithë anëtarët deklaruan mosqenien në kushtet e konfliktit të interesit. Subjekti nuk u shpreh për konflikt interesi me ndonjë nga anëtarët e trupit gjykues.

5. Me vendimin nr. 2, datë 18.6.2021, trupi gjykues vendosi mbylljen e hetimit administrativ bazuar vetëm në kriterin e pasurisë.

6. Në datën 21.6.2021, përmes postës elektronike, trupi gjykues njoftoi subjektin e rivlerësimit mbi: (i) rezultatet e hetimit kryesisht; (ii) kalimin e barrës së provës, sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, për të provuar të kundërtën, jo më vonë se data 28.6.2021; (iii) njohjen me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016, si dhe nenet 45 - 47 dhe 35 - 40, të Kodit të Procedurave Administrative.

7. Në datën 28.6.2021, subjekti paraqiti një kërkesë përmes postës elektronike, nëpërmjet së cilës kërkoi zgjatjen e afatit të përcaktuar nga Komisioni për dorëzimin e shpjegimeve dhe provave mbi barrën e

provës, për shkak të pamundësisë objektive për të siguruar brenda afatit gjithë dokumentacionin e kërkuar.

8. Me vendimin nr. 3, datë 29.6.2021, Komisioni vendosi të shtyjë afatin për dërgimin e përgjigjeve deri në datën 7.7.2021 dhe zhvillimin e seancës dëgjimore në datën 8.7.2021. Ky vendim i është njoftuar subjektit përmes postës elektronike, po në datën 29.6.2021.

9. Në datën 7.7.2021, përmes postës elektronike, subjekti dërgoi disa dokumente dhe prova shkresore në funksion të rezultateve të hetimit, por jo shpjegime mbi rezultatet e hetimit.

10. Po, në datën 7.7.2021, përmes postës elektronike avokatja R. Z., informoi Komisionin se ishte caktuar si përfaqësuese ligjore e subjektit të rivlerësimit Arben Smaçi duke bashkëngjitur prokurën e posaçme nr. ***, datë 7.7.2021 dhe për shkak të pamundësisë së saj fizike për të qenë e pranishme në seancën e datës 8.7.2021, ka kërkuar shtyrjen e ditës së seancës dëgjimore.

11. Në seancën dëgjimore të datës 8.7.2021, subjekti paraqiti një kërkesë me shkrim për shtyrje të seancës dëgjimore me dy javë, duke informuar Komisionin se do të përfaqësohej nga avokatja R. Z., e cila ishte në pamundësi objektive për të ndjekur seancën dëgjimore, ashtu sikurse ka bërë me dije me e-mail të datës 7.7.2021, pasi i nevojitej më tepër kohë për t'u përgatitur.

12. Trupi gjykues u tërhoq për të marrë vendim mbi kërkesën e subjektit dhe me vendimin nr. 4, datë 8.7.2021, vendosi të shtyjë zhvillimin e seancës dëgjimore për në datën 15.7.2021.

13. Në datën 14.7.2021, përmes postës elektronike subjekti i rivlerësimit Arben Smaçi kërkoi: (i) njohjen me rezultatet e hetimit administrativ lidhur me kriterin e kontrollit të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale; (ii) përfundimin e procesit administrativ bazuar në të tria kriteret e vlerësimit, si dhe paraqiti shpjegimet e tij mbi rezultatet e hetimit.

14. Me vendimin nr. 5, datë 14.7.2021, trupi gjykues vendosi mospranimin e kërkesave të subjektit të rivlerësimit, vendim i cili i u njoftua subjektit në seancën dëgjimore të datës 15.7.2021.

15. Në datën 15.7.2021, u zhvillua seanca dëgjimore, në të cilën subjekti i rivlerësimit ishte i pranishëm në prani edhe të avokates R. Z. dhe në përfundim kërkoi konfirmimin në detyrë.

II. PARIME TË PËRGJITHSHME TË PROCESIT TË RIVLERËSIMIT

16. Procesi i rivlerësimit që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

17. Parashikimet e ligjit nr. 84/2016 kanë përcaktuar qartë të gjitha rregullat e posaçme për kryerjen e rivlerësimit mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera, që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor.

18. Sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit. Sipas kreut V të ligjit nr. 84/2016, DSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin në lidhje me

kontrollin e figurës. Sipas kreut VI të ligjit nr. 84/2016, parashikohen burimet për rivlerësimin e aftësive profesionale dhe procedura që duhet të ndiqet nga organet ndihmëse.

19. Referuar vendimit nr. 2/201721 të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

III. FAKTET DHE PROVAT MBI TË CILAT ËSHTË MARRË VENDIMI

20. Në zbatim të nenit 31/1 të ligjit nr. 84/2016, rezulton se subjekti i rivlerësimit Arben Smaçi, ka dorëzuar pranë ILDKPKI-së deklaratën e pasurisë në datën 26.1.2017, pra, në periudhën kur ligji ka qenë në fuqi dhe brenda afatit 30-ditor nga hyrja e tij në fuqi. Gjithashtu, në referencë të nenit 32/2 të ligjit nr. 84/2016 dhe në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarinimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, si dhe ligjit nr. 9367, datë 10.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, vërehet se subjekti i rivlerësimit Arben Smaçi, është bërë subjekt deklarues në ILDKPKI në vitin 2010, me nr. indeksi 09940 dhe ka dorëzuar rregullisht deklaratat e interesave private në vijim.

21. ILDKPKI-ja ka dërguar aktin e përfundimit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë, ku në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera për subjektin Arben Smaçi, ka konstatuar se: (i) deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin; (ii) ka burime të ligjshme për të justifikuar pasuritë; (iii) nuk ka kryer fshehje të pasurisë; (iv) nuk ka kryer deklarim të rremë; (v) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

22. Në përmbushje të funksioneve të tij kushtetuese, sipas pikës 1, të nenit 45, të ligjit nr. 84/2016, Komisioni ka kryer një proces të plotë hetimi administrativ për pasurinë e subjektit të rivlerësimit Arben Smaçi, si dhe të personave të lidhur me të, sipas dispozitave ligjore të kreut VII të ligjit nr. 84/2016, bazuar në: (i) deklarinimet e subjektit në ILDKPKI; (ii) provat shkresore të administruara nga ky institucion dhe raporti i dorëzuar në Komision; (iii) çdo dokument ligjor që përbën mjet prove ligjore të kërkuar nga Komisioni gjatë procesit të rivlerësimit sipas nenit 49 të ligjit nr. 84/2016; si dhe (iv) komunikimet me subjektin sipas nenit 46 të ligjit nr. 84/2016 dhe dispozitave përkatëse të Kodit të Procedurave Administrative.

23. Hetimi administrativ në lidhje me rivlerësimin e pasurisë, konsistoi në: (i) verifikimin e vërtetësisë së deklarinimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe të personave të lidhur; (ii) verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve, me qëllim evidentimin ose jo të mungesës së burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; (iii) evidentimin ose jo të fshehjes së pasurive; (iv) evidentimin e deklarinimeve të rreme; si dhe (v) nëse subjekti ndodhet në situatën e konfliktit të interesit, me qëllim verifikimin e deklarinimeve të pamjaftueshme në lidhje me kriterin pasuror, sipas parashikimit të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, i cili i referohet nenit 33 të tij.

24. Në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar: “*Kontratë për premtim blerje apartamenti nr. *** me sip. 123.3 m² në rr. ‘N. M.’, Tiranë në shumën 50.000 euro. Pjesa takuese: 100 %. Burimi i krijimit: kjo pasuri është blere mbi bazën e të ardhurave nga paga, kursimet e realizuara ndër vite gjatë punës*”

sime dhe interesat bankare, të ardhurat e sjella nga vëllai në Angli dhe gjatë kohës që ka qenë emigrant ilegal në Greqi, si dhe huaja e marrë në shumën e 20.000 eurove. Kjo shumë është shlyer e gjitha në vitin 2015. Në datën 18.5.2015 kam tërhequr nga BKT-ja shumën e parave që i kisha lënë në depozite bankare, kjo është bërë me qëllim shlyerjen e blerjes së apartamentit në vlerën 3,061,779 lekë. Pjesa takuese: 100%. Kjo shumë e cila ishte depozitë, ka ardhur si rezultat i kursimeve të mia si prokuror, nga bursa ime si student i Shkollës së Magjistraturës, nga paga ime si jurist në Bashkinë Dibër dhe nga emigracioni nga vëllai im P. S., në Greqi”.

25. Në lidhje me statusin aktual të kësaj pasurie, gjatë hetimit administrativ ka rezultuar se:

25.1. ASHK Tirana Jug¹ konfirmoi të regjistruar në bashkëpronësi të shtetasve Arben Smaçi dhe E. S. pasurinë nr. ***, z. k. ***, të llojit apartament me sip. 111.5 m², me adresë rruga “N. M.”, shk. ***, k. ***, ap. ***, Tiranë, pasuri e cila sipas të dhënave të kartelës së pasurisë është regjistruar në pronësi të tyre në datën 27.7.2020, pra, pas dorëzimit të deklaratës *Vetting*.

25.2. FSHU-ja² konfirmoi se subjekti është abonent me kontratë furnizimi Nr. ***, në Instancën Tiranë, ku referuar detajeve të abonentit, pagesat për shpenzimin e energjisë nisin në shtator të vitit 2016, çka përputhet me deklarinimin e subjektit në përgjigje të pyetësorit nr. 1, se jetesën në apartament e ka nisur në shtator të vitit 2016. Bashkëngjitur përgjigjeve subjekti paraqiti librezën e energjisë së kontratës *** që i përket adresës rruga “A. L.”, shk. ***, ap. ***, e cila në periudhën 2016 – janar 2020 ka qenë në emër të shoqërisë “H.” sh.p.k., ndërsa duke nisur që prej shkurt të vitit 2020 është në emër të Arben Smaçi. Ndërsa në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti informoi dhe vërtetoi se adresa e kësaj pasurie regjistruar në rr. “N. M.”, është ndryshuar në vitin 2017, duke u emërtuar “Nj. 7, rr. ‘A. L.’, kompleksi ‘M.’, pall. ‘O.’, ap. ***, Tiranë”.

25.3. UKT-ja³ konfirmon në emër të subjektit Arben A. Smaçi, kontratën e furnizimit me ujë Nr. *** që i përket adresës rruga “N. M.”, kompleksi “M.”.

26. Në lidhje me origjinën dhe mënyrën e fitimit të pronësisë, nga verifikimi akteve në dosjen e ILDKPKI-së dhe dokumentacionit të administruara nga Komisioni gjatë hetimit administrativ⁴ rezultoi se në rend kronologjik janë kryer veprimet juridike të mëposhtme:

26.1. Sipas kontratës së sipërmarrjes nr. ***, datë 15.5.2015, pala investitore shoqëria “H.” sh.p.k., ka marrë përsipër të ndërtojë për shtetasin Xh. B. apartamentin nr. ***, me sipërfaqe të përgjithshme 123.3 m², me sipërfaqe individuale 111.5 m² dhe sipërfaqe të përbashkët 11.8 m², ndodhur në katin e dytë të banimit në kompleksin “M.”, në çmimin e përgjithshëm 90.000 euro, i cili do të paguhet në llogaritë bankare të përcaktuara nga sipërmarrësi.

26.2. Po në të njëjtën ditë, datë 15.5.2015, si dhe menjëherë pas aktit të sipërpërmendur, është lidhur kontrata për premtim shitje nr. ***, datë 15.5.2015, midis palëve: premtues shitës Xh. B. dhe bashkëshortja L. B.; premtues blerës Arben Smaçi dhe pëlqim dhënës shoqëria “H.” sh.p.k., sipas të

¹ Shihni shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 5.2.2021, nga ASHK Tirana Jug, në dosjen e Komisionit.

² Shihni shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 21.1.2021, si dhe shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 16.2.2021, nga FSHU në dosjen e Komisionit.

³ Shihni shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 26.1.2021, nga UKT-ja në dosjen e Komisionit.

⁴ Shihni aktet ne aneksin nr. 4/2, në dosjen e ILDKPKI-së; dokumentet bashkëngjitur shkresës kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 5.2.2021, nga ASHK Tirana Jug dhe dokumentet e dërguara në rrugë elektronike në datën 17.6.2021 nga shoqëria “H.” sh.p.k., në dosjen e Komisionit.

cilës, premtuesi shitës i premtion premtuesit blerës kalimin e të drejtave të pronësisë mbi apartamentin e banimit të lartpërmendur nr. 221, kundrejt çmimit 50.000 euro. Në DPV-në e vitit 2015, subjekti e ka deklaruar këtë kontratë me të njëjtën vlerë dhe njëjtin burim të deklaruar edhe në deklaratën *Vetting*.

26.3. Sipas certifikatës për vërtetim pronësie nr. ***, apartamenti nr. ***, ishte regjistruar në datën 9.4.2020, në pronësi të shoqërive “K.” sh.p.k. dhe “H.” sh.p.k., si pasuria me nr. ***.

26.4. Sipas kontratës së shitjes nr. ***, datë 8.7.2020, pala shitëse shoqëria “H.” sh.p.k. dhe shoqëria “K.t” sh.p.k. (të dyja të përfaqësuara nga z. F. B.) i kanë shitur pasurinë e paluajtshme nr. ***, blerësit Arben Smaçi, i cili i ka likuiduar z. Xh. B. vlerën 50.000 euro.

26.5. Në datën 27.7.2020, është regjistruar pasuria nr. ***, në emër të bashkëshorteve Smaçi. Në kartelën e pasurisë lëshuar në emër të tyre, vlera e pasurisë së shitur është 90.000 euro.

27. Në lidhje me çmimin e shitjes së pasurisë dhe mënyrën e likuidimit të tij, rezultoi se:

27.1. Kontrata për premtim shitje nr. ***, datë 15.5.2015, parashikon se çmimi prej 50.000 euro do të paguhet i plotë nga premtuesi blerës (subjekti) në llogarinë bankare të premtuesit shitës (Xh. B.). Për sa i takon likuidimit faktik të kësaj shume, nga aktet në dosjen e ILDKPKI-së⁵ dhe nga verifikimi i lëvizjeve të llogarisë në BKT, ka rezultuar se subjekti ka bërë tri transfera/depozitime në BKT në favor të z. Xh. B. për likuidimin e shumës prej 50.000 euro brenda vitit 2015, si vijojnë: (i) në datën 18.5.2015, shuma 28.720 euro është depozituar *cash* në llogarinë e z. Xh. B. në BKT me përshkrimin *Arben Smaçi derdhje në llogarinë për blerje apartamenti*. Nga verifikimi i lëvizjeve bankare të subjektit, rezultoi se në këtë datë është tërhequr nga subjekti shuma prej 3.061.779 lekësh nga BKT; (ii) në datën 25.5.2015, shuma prej 20.000 euro është transferuar nga llogaria e z. Arben Smaçi në llogarinë e z. Xh. B. me përshkrimin *blerje apartamenti në Tiranë*. Kjo shumë është transferuar në të njëjtën datë, nga llogaria e shtetasit N. F. në llogarinë e shtetasit Arben Smaçi me përshkrimin *hua për shlyerje apartamenti Tiranë, në favor të z. Arben Smaçi*; (iii) në datën 8.6.2015, është depozituar *cash* prej subjektit Arben Smaçi në llogarinë e z. Xh. B. në BKT shuma 1.280 euro me përshkrimin *Arben Smaçi derdhje në llogari për blerje apartamenti*.

27. 2. Kontrata e shitjes së pasurisë me nr. ***, datë 8.7.2020, midis të tjerash parashikon: “*Sipas kontratës së sipërmarrjes (për prenotim apartamenti) me nr. ***, datë 15.5.2015, pala shitëse është shlyer për çmimin e përgjithshëm të shitjes prej 90.000 euro nga Xh. B. (porositësi) dhe nuk ka asnjë pretendim në lidhje me këtë shumë. Ndërsa Arben Smaçi (blerësi/premtuesi blerës), sipas kontratës së premtim shitjes nr. ***, datë 15.5.2015, ka shlyer shtetasin Xh. B. (premtuesi shitës) vlerën totale prej 50.000 euro*”.

28. Siç vërehet në kontratën e shitjes së pasurisë, çmimi i shitjes së pasurisë te blerësi i parë shtetasi Xh. B. është 90.000 euro, ndërsa vlera e paguar nga subjekti i rivlerësimit si blerës i dytë, te po ky shtetas, është 50.000 euro. Po kështu, vërehet se në kontratë nuk ka një përcaktim specifik të çmimit të shitjes së pasurisë nga shitësi Xh. B. te subjekti i rivlerësimit, ashtu sikurse kërkon neni 705 i Kodit Civil, por është evidentuar vetëm fakti që subjekti ka shlyer këtë shtetas në vlerën 50.000 euro.

29. Me qëllim verifikimin e vlerës së pasurisë sipas çmimit të referencës, Komisioni iu referua Udhëzimit nr. 4, datë 30.9.2015, të Këshillit të Ministrave, sipas të cilit, çmimi i referencës për zonën

⁵ Shihni aktet në aneksin 4/2 të dosjes së ILDKPKI-së.

*** të qytetit të Tiranës, ku ndodhet apartamenti i subjektit, rezulton të jetë 65.000 lekë/m². Kjo do të thotë se vlera e apartamentit sipas çmimeve të referencës është 7.995.000 lekë (65.000 lekë/m²x123 m²), ndërsa subjekti e ka blerë në vlerën prej 50.000 euro/6.864.000 lekë.

30. Me qëllim qartësimin e situatës në lidhje me çmimin e blerjes së pasurisë nga subjekti i rivlerësimit, u ndërmorën hapat hetimore si vijojnë:

30.1. U pyet subjekti në lidhje me shkakun e blerjes së pasurisë 50.000 euro, ndërkohë që shtetasi Xh. B. e kishte blerë 90.000 euro dhe në përgjigje të pyetësorit nr. 2, z. Arben Smaçi deklaroi se ky shtetas kishte përfituar disa apartamente në kompleksin “M.”, për shkak se ishte pronar i një pjese të truallit, ku ishte ndërtuar ky kompleks banimi. Po kështu, sipas tij, apartamenti i blerë ishte në një pozicion jo shumë të favorshëm⁶ dhe i vetmi dhe i fundit në llojin e vet dhe, për këtë arsye, nuk kishte kërkesa për blerjen e tij. Në këto rrethana dhe duke qenë nevojtar, ka pranuar kushtet e apartamentit duke negociuar çmimin e blerjes me z. Xh. B.. Për sa i takon sqarimeve rreth çmimit prej 90.000 me të cilin Xh. B. e kishte blerë pasurinë, subjekti nuk është shumë i qartë në deklaratime, por, sqaron se këtë apartament z. Xh. B. e kishte përfituar si dividend në shoqërinë “H.” sh.p.k., ku ka qenë aksioner. Sipas subjektit, në pamundësi të pagesës së dividendit nga shoqëria ndaj aksionerit Xh. B., është rënë dakord që t’i jepej një apartament që ta shiste dhe çmimi i caktuar të ishte vlera e dividendit që do të përfitonte nga kompania si çmim reference në raport me të gjithë aksionerët e tjerë dhe pronarët e truallit. Sipas subjektit, kjo shumë nuk ishte paguar në momentin e nënshkrimit të kontratës, por nga viti 2016 dhe në vazhdim, kur nga firma ishin shpërndarë dividendët e vitit 2015 dhe ashtu siç e kishte marrë këtë dividend, z. Xh. B., e kishte kaluar për llogari të subjektit ndërtues, deklarime që faktikisht kanë të bëjnë me mundësinë financiare të këtij shtetasi për të paguar shumën 90.000 euro, e cila nuk është në fokus të hetimeve të Komisionit. Për të provuar deklaratimet e tij, subjekti ka paraqitur lëvizjet e llogarive bankare të shoqërisë “H.” sh.p.k., që vërtetojnë transferim dividendi në favor të shtetasit Xh. B. vetëm në gusht të vitit 2019, si dhe deklaratën noteriale nr. ***, datë 13.4.2021, të këtij shtetasi, i cili deklaroi se: “ ... kur më janë kryer pagesa nga dividendi i shoqërisë ‘H.’ sh.p.k., nga pjesa që kam përfituar prej tyre kam bërë edhe shlyerjen e kontratës në vlerën 90.000 euro ”.

30.2. Iu kërkua shoqërisë “H.” sh.p.k. informacion në lidhje me mënyrën e likuidimit të çmimit të shitjes prej 90.000 euro nga shtetasi Xh. B., e cila informoi se kjo vlerë është likuiduar në rrugë bankare, duke vënë në dispozicion gjendjen e llogarisë bankare të shoqërisë në “Union Bank”, sipas të cilës në favor të shoqërisë janë kryer disa pagesa⁷, siç tregohet në tabelën më poshtë.

Nr.	Data	Paguar (në euro)	Përshkrimi i pagesës në depozitimet cash
1	7.11.2016	1 350	Pagesë për shoqërinë “H.” sh.p.k., ap. ***, obj. “O.”, Arben Smaçi
2	16.11.2016	6 960	Pagesë për shoqërinë “H.” sh.p.k., ap. ***, obj. “O.”, Arben Smaçi
3	1.12.2016	7 000	Arben Smaçi për shoqërinë “H.” sh.p.k., ap. ***, obj. “O.”
4	2.12.2016	7 000	Arben Smaçi për shoqërinë “H.” sh.p.k., pag. ap. ***, obj. “O.”
5	27.12.2016	7 000	Arben Smaçi për shoqërinë “H.” sh.p.k., pag. ap. ***, obj. “O.”

⁶ Subjekti e argumenton pozicionin e pafavorshëm të apartamentit duke përshkruar ...kati i 1-rë i banimit, direkt sipër dyqaneve dhe lokaleve të cilat krijojnë zhurmë për banorët që janë direkt sipër tyre...ky pallat dhe apartamenti është afër rrugës kryesore duke qenë problem për zhurmat ...dhe për shkak të pluhurave të rrugës, pasi është shumë afër rrugës dhe pjesës hyrëse për në parkingun e kompleksit.

⁷ Shihni përgjigjen dhe dokumentuat bashkëngjitur dërguar në rrugë elektronike nga shoqëria “H.” sh.p.k., në dosjen e Komisionit

6	29.12.2016	7 000	Xh. B. për shoqërinë "H." sh.p.k., pag. ap. ***, obj. "O."
7	30.12.2016	7 000	Xh. B. për shoqërinë "H." sh.p.k., pag. ap. ***, obj. "O."
8	30.12.2016	7 000	Xh. B. për shoqërinë "H." sh.p.k., pag. ap. ***, obj. "O."
9	13.2.2017	7 000	Xh. B. pag. këst ap. ***, obj. "O."
10	16.2.2017	7 000	Xh. B. për shoqërinë "H." sh.p.k., pag. ap. ***, obj. "O."
11	22.2.2017	531.200 lekë/ 3.935 euro	Xh. B. për shoqërinë "H." sh.p.k., pag. ap. ***, obj. "O."
12	29.3.2017	729.000 lekë/ 5.380 euro	Arben Smaçi për shoqërinë "H." sh.p.k., pag. ap. ***, obj. "O.", dep. Xh. B.
13	28.8.2019	16 375	Xh. H. B. kalim fondi për shoqërinë "H." sh.p.k., pagesë ap. *** obj. "O."
Total		90 000	

30.3. Nga verifikimi i veprimeve bankare vërehet se i gjithë çmimi prej 90.000 euro, i është paguar shoqërisë "H." sh.p.k., gjatë viteve 2016 – 2019. Nga kjo shumë, z. Xh. B., ka likuiduar nëpërmjet shtatë pagesave në total shumën prej 55.310 euro, nga të cilat 50.000 euro i kishte marrë në dorëzim prej subjektit që në vitin 2015, me lidhjen e kontratës për premtim shitje nr. ***, datë 15.5.2015, ndërsa subjekti duket që të këtë likuiduara shumën totale prej 34.960 euro, nëpërmjet gjashtë pagesash në *cash* në llogari të shoqërisë me destinacion të mirëpërcaktuar për shoqërinë "H." sh.p.k., pagesa për ap. ***, objekti "O."⁸, i cili është apartamenti i blerë nga subjekti referuar kontratës së shitblerjes nr. ***, datë 8.7.2020.

30.4. Me kërkesë të Komisionit shoqëria "H." sh.p.k., paraqiti në rrugë elektronike 11 kontrata të tjera shitjeje, të cilat kishin për objekt apartamente të ndodhura në të njëjtën godinë/ strukturën *** të kompleksit "M.", me palë shitëse shoqëritë "C." sh.p.k. dhe "H." sh.p.k.,⁹ nga verifikimi i të cilave u konstatua se:

i) Çmimet për metër katror të blerësve për të gjitha apartamentet variojnë nga çmimi minimal prej 735 euro/m², në çmimin maksimal prej 816 euro/m². Ndërkohë që, referuar vlerës 50.000 euro të kontratës

⁸ Në kontratën e sipërmarrjes mes "H." sh.p.k. dhe shtetasit Xh. B., përshkruhet se kjo shoqëria po ndërton kompleksin rezidencial "M.", struktura *** , 4,8,9 kate banimi, dhe objekt i kësaj kontrate është apartamenti nr. ***. Ndërsa në e-mail-in e datës 17.6.2021, shoqëria "H." sh.p.k. informon që kontratat e z. Arben Smaçi gjenden në objektin "O."

⁹ Shihni dokumentet e dërguara në rrugë elektronike nga shoqëria "H." sh.p.k., në datat 17.6.2021 dhe 18.6.2021: (1) kontratë shitje nr. ***, datë 8.7.2020, me palë blerëse Arben Smaçi, me objekt shitje, apartament me sip. 111.5 m² (hyrja 2, ap. 5) me çmim 50.000 euro; 435 euro/m²; (2) kontratë shitje nr. ***, datë 5.5.2020, me palë blerëse E. L. etj., me objekt shitje apartament me sip. 54.9 m², (hyrja 2, ap. 2), me çmim 42.900 euro; 782 euro/m²; (3) kontratë shitje nr. ***, datë 7.5.2020, me palë blerëse Vllasi Çobo etj., me objekt shitje apartament me sip 83.1m² (hyrja 2, ap.2) me çmim 61.164 euro; 736 euro/m²; (4) kontratë shitje nr. ***, datë 10.9.2020, me blerës V. K., me objekt shitblerje apartament me sip. 52.7 m² (hyrja 2, ap. 8), me çmim 42.486 euro; 806 euro/m²; (5) kontratë shitje nr. ***, datë 5.5.2020, me blerës N. M., me objekt shitje apartament me sip 80.3 m² (hyrja 2, ap. 33), me çmim 65 000 euro; 810 euro/m²; (6) kontratë shitje nr. ***, datë 4.8.2020, me palë blerëse S. H., me sip. 80.3 m² (hyrja 2, ap. 29), me çmim 65.000 euro; 810 euro/m²; (7) kontratë shitje nr. ***, datë 1.5.2020, me palë blerëse P. D., me objekt shitje apartament me sip 81.8 m² (hyrja 1, ap.16), me çmim 64.000 euro; 782 euro/m²; (8) kontratë shitje nr. ***, datë 5.5.2020, me palë blerëse B. A., me objekt shitje apartament me sip. 82.1m² (hyrja 1, ap.18), me çmim 66 500 euro; 810 euro/m²; (9) kontratë shitje nr. ***, datë 28.5.2020, me palë blerëse Gj. Gj., me objekt shitje apartament me sip 81.2m² (hyrja 1, ap. 13), me çmim 65.000 euro; 10. 800 euro/m²; (10) kontratë shitje nr. ***, datë 27.4.2020, me palë blerëse M. H. etj, me objekt shitje apartament me sip 84.1 m² (hyrja 1, ap. 22), me çmim 68.620 euro; 816 euro/m²; (11) kontratë shitje nr. ***, datë 7.5.2020, me palë blerëse V. J. etj, me objekt shitje apartament me sip 81.8 m²(hyrja 1, ap. 32), me çmim 64.500 euro; 789 euro/m²; (12) kontratë shitje nr. ***, datë 3.9.2020, me palë blerëse E. H. etj., me objekt shitje apartament me sip. 80.3m² (hyrja 2, ap.7), me çmim 64.000 euro; 797 euro/m²; (13) kontratë sipërmarrje nr. ***, datë 7.2.2019, me palë blerëse Sh. K., me objekt shitje dy njësi shërbimi me sip. 118.8 m², me çmim 125.000 euro; 1502 euro/m².

subjekti¹⁰ ka paguar 435 euro/m². Pra, siç vërehet, subjekti e ka blerë këtë pasuri pothuajse sa ½ e çmimit për metër katror që e kanë blerë blerësit e tjerë.

ii) Sa i takon pretendimit të subjektit që apartamenti është blerë më lirë për shkak të pozicionit të pafavorshëm sepse ndodhet në katin e parë, nuk qëndron, pasi referuar dy kontratave për dy apartamente të ndodhura në të njëjtin kat me subjektin, blerë përkatësisht nga shtetasit E. H. dhe V. K., rezulton se këto pasuri janë blerë në një çmim për metër katror, rreth dy herë më lartë se çmimi i paguar nga subjekti i rivlerësimit.

iii) Sa i takon pretendimit të subjektit se një nga shkaqet e shitjes më lirë ka qenë se apartamenti i tij është shitur i fundit, kjo vjen në kundërshtim me faktet, pasi në datën 25.6.2015, pra, rreth një muaj e gjysmë, pasi është lidhur kontrata e sipërmarrjes midis shoqërive “H.” dhe “K.” sh.p.k. dhe shtetasit Xh. B. për apartamentin objekt shqyrtimi, rezulton të jetë lidhur një tjetër kontratë sipërmarrje midis shoqërive të sipërcituara dhe shtetasës S. H..

30.5. Sa i takon një konflikti të mundshëm interesi, nga verifikimet e kryera, por edhe nga dokumentacioni i paraqitur nga subjekti¹¹ nuk ka rezultuar që të ketë shqyrtuar çështje ku pjesëmarrës me çfarëdolloj statusi të kenë qenë administratorët e shoqërive në cilësinë e palës shitëse apo të ketë pasur procedime penale e pasurore ndaj tyre.

31. Në përfundim të hetimit administrativ në lidhje me çmimin e blerjes së pasurisë, nga të gjitha provat dhe faktet e administruara, si më sipër në mënyrë të përmbledhur, ka rezultuar se:

i) Me kontratën e sipërmarrjes nr. ***, datë 15.5.2015, pala investitore shoqëria “H.” sh.p.k., ka marrë përsipër të ndërtojë për shtetasin Xh. B. apartamentin me nr. ***, i cili ndodhet në një godinë banimi në kompleksin “M., në çmimin 90.000 euro.

ii) Në të njëjtën datë, më 15.5.2015, me kontratë premtim shitje nr. ***, blerësi i parë i pasurisë, shtetasi Xh. B., i kalon të drejtat e pronësisë blerësit të dytë, subjektit të rivlerësimit, kundrejt çmimit 50.000 euro.

iii) Me kontratën e shitjes së pasurisë së paluajtshme nr. ***, datë 8.7.2020, shoqëria “H.” sh.p.k. dhe shoqëria “K.” sh.p.k., i shesin blerësit Arben Smaçi pasurinë. Në këtë kontratë përcaktohet se çmimi i shitjes së pasurisë të shtetasit Xh. B. është 90.000 euro, ndërsa subjekti Arben Smaçi i ka shlyer atij vlerën prej 50.000 euro, duke e lënë të paqartë sa është çmimi i shitjes së pasurisë të subjektit të rivlerësimit.

iv) Vlera e apartamentit sipas çmimeve të referencës është 1.131.000 lekë më e lartë se çmimi i shitjes prej 50.000 euro/6.864.000 lekë deklaruar nga subjekti.

v) Në datën 27.7.2020, është regjistruar pasuria nr. *** në emër të bashkëshortëve Smaçi. Në kartelën e pasurisë lëshuar në emër të tyre, vlera e pasurisë së shitur është 90.000 euro.

¹⁰ Çmimi për metër katror në të gjitha kontratat e administruara, përfshirë atë të subjektit, është përlllogarit bazuar në sipërfaqet e brendshme, pa sipërfaqet e përbashkëta.

¹¹ Shihni shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 20.5.2021, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër; shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 20.5.2021, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës; shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 27.5.2021, nga SPAK në dosjen e Komisionit; si dhe përgjigjet e dokumentet e paraqitura nga subjekti në përgjigje të pyetësorit nr. 2.

vi) Në deklaratimet e tij subjekti e ka pranuar faktin që vlera e pasurisë të përfitur nga z. Xh. B., është 90.000 euro, fakt i vërtetuar edhe me dokumentacionin shkresor të administruar. Por, pretendon që këtë pasuri ta ketë blerë në vlerën 50.000 euro për shkak të pozicionit të pafavorshëm të apartamentit, deklaram i cili është i pavërtetë për sa kohë që shtetasi Xh. B. kishte pranuar të blinte këtë apartament, po në të njëjtin pozicion, në vlerën 90.000 euro, në të njëjtën ditë që ky shtetas kishte lidhur kontratën me subjektin. Veç kësaj, pretendimet e subjektit rezultuan të pabazuara referuar kontratave të tjera të shitjeve. Pra, z. Xh. B., nga shitja e këtij apartamenti duket se ka pësuar një humbje në vlerën prej 40.000 euro.

vii) Subjekti ka kryer depozitime *cash* në llogarinë e shoqërisë “H.” sh.p.k. në vlerën totale prej 34.960 euro, me përshkrim *pagesa për të blerë apartamentin me nr. ****, e cila së bashku me shumën prej 50.000 euro likuiduar në vitin 2015 shtetasit Xh. B. (i cili ia ka kaluar shoqërisë në vitet 2016 - 2019), përbejnë vlerën prej 84.960 euro. Pra, vlera e dokumentuar e paguar nga subjekti për blerjen e pasurisë është 84.960 euro, e cila është shumë e përafërt me vlerën prej 90.000 euro.

Për të gjitha këto arsye, në analizën financiare në përfundim të hetimit administrativ, çmimi i blerjes së apartamentit nga subjekti u konsiderua në vlerën 90.000 euro.

Analizë e burimeve të deklaruara për blerjen e pasurisë

32. Në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar si burim për blerjen e pasurisë: të ardhurat nga pagat, kursimet e realizuara, ndër vite, si dhe interesat bankare. Me qëllim vërtetimin e këtyre të ardhurave, gjatë hetimit administrativ u kryen verifikimet përkatëse nga ku konstatua se: (i) për periudhën 1.1.2015 – 8.6.2015, kur është blerë pasuria, të ardhurat e dokumentuara nga pagat e subjektit janë në vlerën 690.959 lekë¹²; (ii) sa i takon interesave bankare, ato janë në vlerën 369.223 lekë, të akumuluar nga investimi i depozitave me afat, duke filluar nga viti 2008 dhe të tërhequra së bashku me depozitat bankare në datën 18.5.2015; (iv) sa i takon kursimeve, ndër vite, subjekti nuk ka deklaruar gjendje *cash* në asnjë prej DPV-ve, ndërsa në deklaratën *Vetting* subjekti ka bërë me dije se në datën 18.5.2015, ka tërhequr nga BKT-ja shumën 3.061.779 lekë, kursime të përdorura për blerjen e pasurisë.

33. Nga verifikimi i lëvizjeve bankare të subjektit në BKT, rezulton se shuma prej 3.061.779 lekësh e ka origjinën në katër shuma të investuara, ndër vite, në disa depozita me afat, të cilat janë tërhequr nga subjekti në datën 18.5.2015 (në të njëjtën datë, pasi është shtuar dhe shuma prej 880.000 lekësh, i është paguar shitësit Xh. B. kësti prej 28.720 euro). Nisur nga data e tërheqjes së tyre, është ndjekur origjina e krijimit të secilës prej katër shumave/depozitave nga ku rezulton se:

i) Shuma 510.625 lekë, e ka origjinën nga një depozitim *cash* prej 500.000 lekësh në BKT, në datën 11.3.2014, e cila është investuar në depozitë me afat deri në datën 18.5.2015. Nga analiza financiare ka rezultuar se subjekti nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme për depozitimimin e shumës fillestare prej 500.000 lekësh në datën 11.3.2014, për shkak të një balance negative në shumën 439.960 lekë.

ii) Shuma 1.031.290 lekë e ka origjinën nga: (a) shuma 350.000 lekë depozituar *cash* në BKT në datën 28.3.2011, e cila rrjedh nga shuma 2.200 euro¹³ e deklaruar si të sjellë nga vëllai i subjektit P. S. në vitin 2006, me burim nga kursimet e tij nga puna në Greqi; (b) shuma 641.600 lekë e depozituar *cash*

¹² Shihni lëvizjet e llogarisë së pagës, sipas shkresës nr. *** prot., datë 19.1.2021, nga “Raiffeisen Bank”, në dosjen e Komisionit.

¹³ Kjo shumë është depozituar në “Raiffeisen Bank” në datën 27.11.2006 dhe është investuar në mënyrë të vazhdueshme deri në datën 25.3.2011, kur shuma e përfitur prej 2.541 euro, bashkë me interesat, është tërhequr nga “Raiffeisen Bank”.

në BKT, në datën 7.6.2013, origjina e së cilës është shuma prej 525.380 lekësh¹⁴ e deklaruar nga subjekti në DPDF, si e sjellë nga vëllai i subjektit P. S. me burim të ardhurat nga emigracioni në Greqi. Të dyja shumat së bashku, në total 1.031.290 lekë, janë investuar në depozitë me afat për periudhën 10.6.2013 – 18.5.2015. Sa i takon të ardhurave të vëllait të subjektit P. S. nga puna e tij në Greqi, subjekti nuk ka paraqitur asnjë dokument shkresor që provon punësimin e tij në shtetin grek apo përfitimin e ndonjë të ardhure prej tij, duke pohuar se vëllai ka punuar në Greqi si emigrant ilegal. Në kuptim të pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, nuk vërtetohet burimi i ligjshëm i shumave të deklaruara si të sjella nga vëllai, të cilat megjithëse janë depozituar nga subjekti para fillimit të detyrës, janë përdorur për blerjen e pasurisë objekt shqyrtimi dhe, për këtë shkak, nuk janë konsideruar si të ardhura ligjore në analizën financiare¹⁵.

iii) Shuma 619.864.76 lekë e ka origjinën nga: (a) shuma 200.000 lekë e depozituar *cash* nga subjekti në BKT, në datën 29.12.2008, me burim *nga paga si jurist në Bashkinë Peshkopi*¹⁶. Sipas analizës financiare të kryer për subjektin para fillimit të detyrës¹⁷ ka rezultuar se subjekti nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme për depozitimin e kësaj shume në datën 29.12.2008 për shkak të një balance negative në shumën 499.919 lekë; (b) shuma 300.000 lekë depozituar *cash* në BKT, në datën 31.12.2012, shumë për të cilën rezulton se subjekti ka pasur të ardhura të mjaftueshme depozitimin e saj¹⁸.

iv) shuma 900.000 lekë është depozituar *cash* në BKT, në datën 9.2.2015, pasi është tërhequr shuma 350.000 lekë nga “Raiffeisen Bank” në të njëjtën datë. Shuma 900.000 lekë është investuar në depozitë me afat deri në datën 18.5.2015 kur është tërhequr. Nga analiza financiare në datën e depozitimit të kësaj shume, më 09.02.2015, ka rezultuar se subjekti nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme për shkak të një balance negative në shumën 609.004 lekë.

34. Të gjitha depozitat e përshkruara më sipër, kanë krijuar shumën 3.061.779 lekë, e cila është përdorur për blerjen e pasurisë. Prej kësaj shume, nga analiza e mësipërme e veprimeve bankare, e kryer duke ndjekur origjinën e krijimit të secilës shumë, në përfundim të hetimit administrativ, ka rezultuar se pjesa prej 2.397.527 lekësh nuk mbulohet me burime të ligjshme, pasqyruar si në tabelën më poshtë dhe, si e tillë, nuk u konsiderua si e ardhur e ligjshme në analizën financiare të vënë në dispozicion të subjektit me rezultatet e hetimit administrativ.

Data e depozitimit	27.11.2006	29.12.2008	17.4.2009	11.3.2014	9.2.2015	Total
Shuma e depozituar	272 147 ¹⁹	200 000	525 380	500 000	900 000	2 397 527

35. Në deklaratën *Vetting* si burim janë deklaruar të ardhurat e sjella nga vëllai i subjektit. Nga verifikimi i DPV, rezulton se subjekti ka deklaruar të ardhura të sjella nga vëllai P. S. vetëm në DPV-në e vitit 2015 dhe, konkretisht, shumat e dërguara nëpërmjet agjencive të transfertave të parave

¹⁴ Kjo shumë është depozituar në “Raiffeisen Bank” në datën 17.4.2009 dhe është investuar në depozitë me afat deri në datën 7.6.2013 kur shuma 641.600 lekë është tërhequr nga “Raiffeisen Bank”.

¹⁵ Shihni vendimin nr. ***, datë 17.12.2018, prg. 25.9 dhe 25.10, të Kolegjit, në të cilin trajtohet kuptimi i të ardhurave të ligjshme nga emigracioni.

¹⁶ Deklaruar në DPDF në datën 9.11.2010.

¹⁷ Në këtë analizë janë përfshirë vetëm të ardhurat dhe shpenzimet e subjektit.

¹⁸ Shihni analizën financiare për vitin 2012.

¹⁹ Në DPDF subjekti ka deklaruar një depozitë në “Raiffeisen Bank” në shumën 2.349 euro me burim “nga puna e vëllait si emigrant në Greqi, sjellë dorazi”. Shuma fillestare prej 2.200 euro është depozituar në “Raiffeisen Bank” në datën 27.11.2006.

“Money Gram” dhe “Western Union”, përkatësisht si vijojnë: 402.301 lekë; 1.078 euro; 2.254 euro; 1.616 euro; 1.597 euro dhe nga shtetasi A. N. (djali i hallës) në shumën prej 904 euro nëpërmjet “Western Union”. Ndërsa, nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur me pyetësin standard, që është i njëjtë me atë të administruara nga ILDKPKI-ja²⁰, konstatohet se subjekti ka vërtetuar transferta parash të ardhura nga jashtë shtetit, nëpërmjet shërbimit “Money Gram”²¹ dhe “Western Union”²², sipas deklarimeve të tij.

36. Sa i takon burimit të dërgesave nga jashtë shtetit, në pyetësin standard, subjekti ka deklaruar se vëllai dhe kushëriri i tij kanë pasur të ardhura nga emigracioni, por nuk ka vënë në dispozicion dokumente shkresore për të vërtetuar këto të ardhura. Me qëllim verifikimin e burimit të ligjshëm të shumave të dërguara, në zbatim të nenit 32/4 të ligjit nr. 84/2016, gjatë procesit të rivlerësimit iu kërkua subjektit të vërtetohet të ardhura të vëllait P. S. dhe të kushëririt A. N. në Mbretërinë e Bashkuar, për të cilat janë paguar detyrimet tatimore. Në përgjigje të pyetësit nr. 2 dhe ato të dërguara elektronikisht në datën 3.6.2021, subjekti ka dhënë disa sqarime dhe ka paraqitur disa dokumente shkresore nga verifikimi i të cilave nuk provohen të ardhura të ligjshme të këtyre shtetasve. Për këtë arsye, në përfundim të hetimit administrativ, dërgesat nga ana e tyre nuk janë përfshirë në analizën financiare si të ardhura të ligjshme.

37. Në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar si burim hua pa interes marrë nga shtetasi N. F. në shumën 20.000 euro për të cilin nga aktet e administruara dhe deklaratimet subjektit, ndër vite, u vërtetua se:

37.1 Shtetasi N. F., sipas deklaratës noteriale nr. ***, datë 25.5.2015²³, ka konfirmuar dhënien e huas në shumën 20.000 euro, subjektit, me qëllim blerjen e apartamentit. Afati i kësaj huaje është 4-vjeçar, duke filluar nga data e nënshkrimit deri më 20.5.2019, me këste prej 5.000 euro/vit, të cilat do të kalojnë në llogarinë bankare të huadhënësit.

37.2. Me transfertë bankare të datës 25.5.2015, pranë BKT-së, nga llogaria e shtetasit N. F. te llogaria e subjektit të rivlerësimit, është transferuar shuma prej 20,000 euro me përshkrimin “*hua për shlyerje apartamenti në Tiranë*”. Po në këtë datë, subjekti ka kaluar në rrugë bankare këtë shumë në llogari të premtuesit të shitjes, z. Xh. B..

- Në DPV-në e vitit 2015 në rubrikën “Detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë”, subjekti ka deklaruar: “*Kontratë huaje pa interes me shtetasin N. F. në shumën 20.000 euro me afat 4-vjeçar, me këst shlyerje në shumën 5.000 euro në vit. Kjo hua është marrë për pagesën e kontratës së*

²⁰ Shihni aneksin 4/6 të ILDKPKI-së.

²¹ Mandat tërheqje, datë 29.04.2015 në shumën 1,616.60 euro, dërgues P. S.; mandat tërheqje datë 13.5.2015 në shumën 1,597.82 euro, dërgues P. S.; mandat tërheqje datë 8.6.2015 në shumën 2,254.56 euro, dërgues P. S.; mandat tërheqje datë 23.12.2015 në shumën 402.301,33 lekë, dërgues P. S.; mandat tërheqje datë 5.3.2016, në shumën 51,180.60 lekë, dërgues P. S. nga Anglia; mandat tërheqje datë 30.4.2016 në shumën 85,709.19 lekë, dërgues P. S. nga Anglia; mandat tërheqje datë 31.5.2016 në shumën 43,076.04 lekë, dërgues P. S. nga Anglia; mandat tërheqje datë 25.6.2016 në shumën 654,820.35 lekë, dërgues P. S. nga Anglia; mandat tërheqje datë 3.8.2016 në shumën 169,712.89 lekë, dërgues P. S. nga Anglia; mandat tërheqje datë 12.9.2016, në shumën 167,947.17 lekë, dërgues P. S. nga Anglia; mandat tërheqje datë 23.12.2016 në shumën 105,939.07 lekë, dërgues P. S. nga Anglia; mandat tërheqje datë 23.1.2017 në shumën 112,098.19 lekë, dërgues P. S. nga Anglia.

²² Mandat tërheqje datë 8.2.2015 në shumën 904.06 euro, dërgues A. N. nga Anglia; mandat tërheqje datë 15.3.2015, në shumën 1,078.93 euro, dërgues P. S. nga Anglia.

²³ Shihni aneksin 4/9 të ILDKPKI-së.

premtim blerjes së apartamentit në Tiranë. Nuk është shlyer asnjë këst, pasi kësti i parë fillon në vitin 2016. Nuk ka filluar shlyerja e kësteve të kontratës”.

-Në DPV-në e vitit 2016 subjekti ka deklaruar se është shlyer shuma 5.000 euro dhe se gjendja e detyrimit të mbetur pa shlyer deri më 31.12.2016 është në shumën 15.000 euro. Me transfertën bankare të datës 4.3.2016, në BKT, është shlyer kësti i parë prej 5.000 euro nga subjekti në favor të shtetasit N. F.. Referuar analizës financiare të vitit 2016, subjekti nuk ka pasur mundësi për ta shlyer këtë këst me të ardhura të ligjshme.

- Në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar detyrimin financiar prej 15.000 euro.

-Në DPV-në e vitit 2017 subjekti ka deklaruar në rubrikën “Detyrime financiare” shumën e mbetur të pashlyer të detyrimit financiar prej 10.000 euro, pasi në datën 13.4.2017 është shlyer shuma prej 5.000 euro. Gjendja e detyrimit të pashlyer deri më 31.12.2017 është 10.000 euro.

-Në deklaratën *Vetting*, në rubrikën “Të dhëna konfidenciale”, subjekti ka deklaruar se kjo shumë e marrë hua është krijuar me të ardhurat nga biznesi, ku shtetasi N. F. është aksioner me 50 % të aksioneve të personi juridik “A.” me NIPT ***, regjistruar në datën 12.5.1994 me kapital prej 38.909.281 lekësh.

38. Sa i takon të ardhurave të ligjshme të shtetasit N. F., nga verifikimi i akteve të vëna në dispozicion nga ILDKPKI-ja²⁴ rezultoi se:

- Shtetasi N. F. është ortak me 50% të kuotave²⁵ në dy shoqëri tregtare (i) “A.” sh.p.k., me NIPT ***, themeluar në vitin 1994 me seli në Shkodër. Nga verifikimi në QKB²⁶, ka rezultuar se në vitin 2015, kur është dhënë huaja prej 20.000 euro te subjekti, shoqëria ka qenë me status AKTIV; si dhe (ii) “I. sh.p.k.”²⁷ e cila është çregjistruar në datën 2.5.2010, duke u përthithur nga shoqëria “A.” sh.p.k.

- Me shkresën nr. *** prot., datë 23.8.2017, DRT-ja Shkodër, informon se shtetasi N. F. ka tërhequr nga shoqëria “A.” sh.p.k. dividend në vlerën 500.000 lekë për secilin nga vitet 2013 dhe 2014.

-Me shkresën nr. *** prot., datë 27.7.2017, ISSH-ja, informon mbi pagën e z. N. F. në shoqërinë “A.” sh.p.k., nga muaji mars i vitit 2012.

39. Bazuar në dokumentacionin e administruar, rezultoi se për periudhën 2012 – 25.5.2015, huadhënësi N. F. ka pasur të ardhura totale në shumën 4.222.737 lekë, ndërsa shpenzime në shumën 3.339.618 lekë²⁸. Pra, ky shtetas ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për t’i dhënë subjektit huan në shumën 20.000 euro në datën 25.5.2015. Veç sa më sipër, Komisioni kreu hetime në drejtim të ndonjë konflikti të mundshëm interesi, me shtetasit N. F. dhe E. R. dhe nuk ka rezultuar²⁹ që subjekti të ketë shqyrtuar çështje, ku pjesëmarrës me çfarëdolloj statusi të kenë qenë këta shtetas.

40. Në përfundim të hetimit administrativ, me ndihmën e Njesisë së Shërbimit Ligjor, Komisioni ka kryer analizën financiare për të verifikuar mundësinë e blerjes së pasurisë në çmimin 90.000 euro, nga

²⁴ Shihni aneksin nr. 30-34, në dosjen e ILDKPIK-së.

²⁵ Ortaku tjetër dhe administroji i të dy shoqërive është shtetasi E. R..

²⁶ Verifikimi është kryer nga Njësia Ligjore e Komisionit, në faqen online të QKB-së, datë 4.5.2021.

²⁷ Shoqëria “I.” sh.p.k. me NIPT ***, e themeluar në datën 28.5.1996 me seli në Shkodër, me ortak E. R. dhe N. F., secili me 50% të kuotave.

²⁸ Këtu përfshihen shpenzimet e jetesës për një person dhe huaja e dhënë në shumën 20.000 euro.

²⁹ Shihni shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 20.5.2021, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër; shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 20.5.2021, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës; dhe shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 27.5.2021, nga SPAK në dosjen e Komisionit.

e cila: (i) shuma prej 50.000 euro është paguar ne vitin 2015; (ii) shuma prej 29.310 euro paguar në vitin 2016; (iii) shuma prej 5.380 euro në vitin 2017; si dhe (iv) për shumën prej 5.310 euro, nuk ka të dhëna kur është paguar. Por duke qenë se pagesat e subjektit janë kryer gjatë viteve 2016 dhe 2017, pjesa prej 5.310 eurosh, është konsideruar si shpenzim i kryer gjatë këtyre viteve, duke u përpjesëtuar në mënyrë të barabartë në shumën 2.655 euro të paguara gjatë secilit vit.

41. Nga kjo analizë, pasqyruar në mënyrë të përmbledhur në tabelën më poshtë, duket se subjekti nuk ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për të paguar çmimin e pretenduar prej 50.000 euro deri në datën 8.6.2015, për shkak të një balance negative në shumën prej 4.011.101 lekësh. Gjithashtu, nuk ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për të paguar shumën prej 31.965 euro³⁰ në vitin 2016, për shkak të një balance negative në shumë prej 5.346.327 lekësh, sikurse ka rezultuar nga analiza financiare për këtë vit, si dhe shumën 8.035 euro³¹ deri në mars të vitit 2017, për shkak të një balance negative në shumën prej 1.199.195 lekësh.

Përshkrimi	8.6.2015	2016	29.3.2017
Pasuria	7 022 978	4 021 828	1 162 146
Apartament sip. 123.3 m ² , në Tiranë, paguar 28.720 euro, kësti 1	3 942 682		
Apartament sip. 123.3 m ² , në Tiranë, paguar 20.000 euro, kësti 2	2 745 600		
Apartament sip. 123.3 m ² , në Tiranë, paguar 1.280 euro, kësti 3	175 718		
Apartament sip. 123.3 m ² , në Tiranë, paguar 31.965 euro		4 322 627	
Apartament sip. 123.3 m ² , në Tiranë, paguar 8.035 euro			1 068 253
<i>Shtesa /pakësime likuiditeteve</i>	<i>158 978</i>	<i>-300 799</i>	<i>93 893</i>
Gjendja e likuiditeteve	41 192	-189 438	-95 545
Të ardhurat	3 511 216	1 183 137	306 936
Të ardhura nga paga e subjektit	690 959	1 183 137	306 936
Të ardhura nga interesa bankare	74 657		
Marrë hua nga shtetasi N. F.	2 745 600		
Shpenzimet	499 339	2 507 637	343 985
Shpenzime jetese për 4 persona	393 251	940 368	229 575
Shlyer huaja te F. F.		676 150	
Shpenzime për kopshtin e vajzës	24 000	18 000	
Shpenzime për shkollën e vajzës		350 922	81 645
Shpenzime transporti	82 088	122 197	32 765
Shpenzime mobilimi		400 000	
Rezultati financiar	-4 011 101	-5 346 327	-1 199 195

42. Sa i takon përlllogaritjes së shpenzimeve të jetesës, duke qenë se në përgjigjet e pyetësorit standard, subjekti ka deklaruar se nga fillimi i detyrës (viti 2010) deri në shtator të vitit 2016 ka jetuar me familjen e origjinës, prindërit A. dhe H. S., vëllezërit P. dhe F. S. dhe nga viti 2013 edhe me bashkëshorten e vëllait P. S.. Për efekt të kryerjes së analizës financiare, subjektit i janë kërkuar të dhëna në lidhje me të ardhurat e familjareve të tij. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka pretenduar se familjarët e tij kanë pasur të ardhura nga prodhimet bujqësore dhe emigracioni dhe se shpenzimet e

³⁰ Në këtë shumë përfshihet shuma e paguar gjatë vitit 2016 në llogarinë e shoqërisë "H." sh.p.k. prej 29.310 euro dhe shuma 2.655 euro si ½ e shumës 5.310 euro e cila nuk është evidentuar të jetë paguar me bankë dhe, për rrjedhojë, është konsideruar si e paguar në *cash*.

³¹ Në këtë shumë përfshihet shuma e paguar në datën 29.3.2017 në llogarinë e shoqërisë "H." sh.p.k. prej 5.380 euro dhe shuma 2.655 euro si ½ e shumës 5.310 euro e cila nuk është evidentuar të jetë paguar me bankë, por është supozuar të jetë paguar *cash*.

jetesës janë përballuar kryesisht prej tyre, si dhe ka paraqitur disa dokumente shkresore³² nga analiza e të cilave rezulton se: (i) babai dhe gjyshi i subjektit kanë në pronësi tokë bujqësore vërtetuar vetëm me AMTP³³, me sipërfaqe 5.100 m²; (ii) Bashkia Dibër, vërteton se shtetasi A. S. ka në pronësi/përdorim tokë më sip. 6.156 m², kategoria e tokës 7 dhe ka aktivitet bujqësor dhe blegtoral, por, nuk janë paraqitur dokumente të cilat provojnë aktivitetin privat dhe të ardhura konkrete nga toka bujqësore; (iii) janë vërtetuar pagesa të sigurimeve shoqërore të prindërve si fermerë private; si dhe (iv) nuk vërtetohet pagesa e taksës bujqësore.

Siç vërehet, subjekti nuk ka dokumentuar të ardhura të ligjshme të familjarëve të tij as nga toka bujqësore dhe as nga emigracioni. Përafërsisht kësaj, në analizën financiare në tabelën më sipër, shpenzimet e jetesës janë llogaritur për 4 persona, për subjektin, bashkëshorten dhe 2 fëmijët e tyre. Familja e tij e origjinës nuk është përfshirë në analizë duke marrë të mirëqenë pretendimin e subjektit se familjarët e tij i kanë përballuar vetë shpenzimet e jetesës. Në këtë mënyrë, në analizën financiare të subjektit, nuk janë përfshirë as të ardhurat e anëtarëve të familjes së origjinës dhe as shpenzimet e tyre, duke mos afektuar këtë analizë.

43. Në lidhje me pasurinë objekt shqyrtimi, apartament banimi në Tiranë, sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit i kaloi barra e provës për të dhënë sqarime dhe prova për të vërtetuar të kundërtën e konstatimeve si vijojnë:

43.1 Duket se subjekti ka kryer deklaram të pasaktë dhe të rremë të çmimit të blerjes së këtij apartamenti në DPV-në e vitit 2015 dhe në deklaratën *Vetting*, pasi bazuar në provat shkresore të administruara, çmimi i blerjes së pasurisë prej tij duket të jetë në vlerën 90.000 euro, aq sa e kishte blere blerësi i parë i pasurisë, shtetasi Xh. B., në të njëjtën ditë që ia shiti blerësit të dytë, subjektit të rivlerësimit (germa “a”, e pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016).

43.2 Duket se subjekti : (i) nuk provoi burimin e ligjshëm të të ardhurave të dërguara nga vëllai emigrant; (ii) nuk provoi burimin e ligjshëm të të ardhurave krijimin e depozitave në BKT të çelura në vitet 2008, 2014 dhe 2015; (iii) nuk ka pasur mundësi për të shlyer këstin e huas shtetasit N. F. në shumën prej 5.000 euro në vitin 2016 dhe, për rrjedhojë, ka mungesë të burimeve të ligjshme financiare

³² Tri certifikata pronësie në emër të babait A. B. S. në Sh., Peshkopi me sip. totale prej 2.556 m².

- Vërtetim nga ASHK Dibër, datë 8.5.2021, i cili vërteton pronësinë e B. V. S. (gjyshi i subjektit) të sip. totale tokë arë me sip. 3.442 m² e shoqëruar me 5 plane rivelimimi për secilën parcelë.

- Akti i marrjes në pronësi të tokës sipas ligjit nr. 7501, për babanë dhe gjyshin e subjektit; foto për banesën në fshat dhe hartë satelitore për vendndodhjen e tokës.

- Vërtetim nga Bashkia Dibër, nr.*** prot., datë 21.5.2021, i cili vërteton se A. S., banor i fshatit Sh., ka në pronësi-përdorim tokë 6.156 m², kategoria e tokës 7 dhe ka aktivitet bujqësor dhe blegtoral.

- Certifikatë pronësie nga ZVRPP-ja Kamëz, Tiranë e A. B. S., për tokë truall, me sip. 500 m² nga e cila ndërtesë 126 m², e shoqëruar me foto të shtëpisë 2-katëshe dhe të oborrit përreth saj i mbjellë me perime dhe pemë frutore.

- Vërtetim nga ISSH Dibër, datë 19.5.2021, për A. B. S. për pagesën e kontributeve të sigurimeve shoqërore si të vetëpunësuar në bujqësi për vitet 2013, 2014 dhe 2015.

-Librezë kontributesh të sigurimeve shoqërore të z. A. S. me nr. serie ***, i cili mban informacion se ky shtetas ka paguar sigurime shoqërore si “fermer privat” në vazhdimësi, nga 1.1.1993 – 31.12.2015.

- Vërtetim nga ISSH Dibër, datë 19.5.2021, për H. B. S., për pagesën e kontributeve të sigurimeve shoqërore si të vetëpunësuar në bujqësi për vitet 2015 – 2020.

-Librezë kontributesh të sigurimeve shoqërore të H. S. me nr. serie ***, i cili përmban informacion se kjo shtetase ka paguar sigurime shoqërore si “fermer privat” në vazhdimësi, nga 1.1.1993 – 31.12.2020.

- Vërtetim mbi bazën e vlerësuar nga ISSH datë 17.5.2021 për F. S. nga shkurt – tetor 2019.

- Vërtetim mbi bazën e vlerësuar nga ISSH datë 17.5.2021 për P. S. nga maj 2012 – prill 2021.

³³ Babai A. S. 2.700 m² dhe gjyshi B. S. 2.400 m².

për pagesën e çmimit të pretenduar prej 50.000 eurosh në vitin 2015, si dhe pagesën e shumës 40.000 euro gjate viteve 2016 dhe 2017 (germa “b”, e pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016).

43.3 Duket se subjekti ka fshehur diferencën/likuiditetin prej 40.000 euro, nga e cila, shuma prej 34.960 euro u vërtetua të jetë depozituar në *cash* prej tij në llogari të shoqërisë “H.” sh.p.k. gjatë viteve 2016 dhe 2017, pa i deklaruar këto pagesa në DPV-të për vitet përkatëse (germa “c”, e pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016).

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit dhe vlerësimi i Komisionit

44. Në parashtrimet e tij, subjekti ka kundërshtuar konstatimet e Komisionit në lidhje me pasurinë objekt shqyrtimi, si vijon:

44.1. Subjekti ka prapësuar se konkluzioni i Komisionit, për sa i takon çmimit të shitjes së pasurisë në vlerën prej 90.000 euro, nuk është i bazuar në prova, pasi sipas tij, nuk është administruar asnjë akt shkresor që të vërtetojë pagesa të kryera prej tij në favor të shoqërisë “H.” sh.p.k. dhe se të gjitha pagesat janë kryer prej shtetasit Xh. B.. Për të vërtetuar këtë pretendim, paraqiti gjendjet e llogarisë bankare të shoqërisë “H.” sh.p.k., ku pasqyroheshin pagesat në shumën totale prej 90.000 euro, të njëjta me ato të administruara edhe nga Komisioni. Gjithashtu, subjekti ka depozituar deklaratën noteriale nr. ***, datë 7.7.2021, të shtetasit Xh. B., i cili pohon të ketë paguar shumën prej 90.000 euro pranë “Union Bank” nëpërmjet 13 pagesash, në kohë dhe sasi të ndryshme, në favor të shoqërisë “H.” sh.p.k. Sipas këtij shtetasi, pagesat janë kryer prej tij ose nga persona të autorizuar prej tij dhe se në asnjë rast këto pagesa nuk janë kryer nga shtetasi Arben Smaçi, por, meqenëse pagesat kishin lidhje me të njëjtin apartament, në ndonjë rast në bankë është përmendur edhe emri i subjektit, për të bërë kështu të mundur identifikimin e apartamentit që i përkiste këtij shtetasi.

Ky deklaram i shtetasit Xh. B. nuk është i besueshëm për shkak se identifikimi i pasurisë në rastin konkret është bërë në mënyre të saktë në secilën prej pagesave, me përshkrimin, *pagesë apartamenti me nr. ***, objekti O.*, numër i shkruar në të gjitha aktet që kanë pasur për objekt këtë pasuri. Nëse do të ishte i domosdoshëm identifikimi i pasurisë nëpërmjet pronarit Arben Smaçi, kjo do të bëhej në të gjitha pagesat dhe jo vetëm në një pjesë të tyre. Gjithashtu, deklarami i z. Xh. B., se subjekti Arben Smaçi nuk ka kryer pagesa, vjen në kundërshtim me katër prej pagesave³⁴, ku përshkrimi i veprimit është tërësisht i qartë, duke treguar se subjekti Arben Smaçi ka kryer pagesa për shoqërinë “H.” sh.p.k. për blerjen e apartamentit me nr. *** në objektin “O.”.

44.2. Në mbështetje të deklaratës noteriale të z. Xh. B., në seancën dëgjimore të datës 15.7.2021, subjekti paraqiti dy mandatpagesa të nënshkruara pranë “Union Bank” nga shtetasi Xh. B., që mbajnë datat 16.11.2016 dhe 29.3.2017, sipas të cilave janë paguar përkatësisht shuma prej 6.960 euro me përshkrimin *pagesë për shoqërinë “H.” sh.p.k., ap. ***, objekti “O.” për Arben Smaçi* dhe shuma 729.000 lekë me përshkrimin *Arben Smaçi për shoqërinë “H.” sh.p.k., pagesë ap. ***, objekti “O.”, dep Xh. B.* Subjekti deklaroi se duke qenë se këto dy mandatpagesa janë nënshkruar prej shtetasit Xh. B., atëherë pagesat janë kryer prej tij. Ndërkohë, ka pretenduar që Komisioni duhet të kërkonte dhe të administronte edhe mandatpagesat e tjera, të cilat deklaroi se nuk janë nënshkruar prej tij. Sa i takon këtij pretendimi, përveç faktit që barra e provës për të vërtetuar të kundërtën e konstatimeve i takon subjektit të rivlerësimit, Komisioni arsyeton se edhe nëse pagesat e tjera do të ishin nënshkruar nga

³⁴ Pagesat e kryera në datat: 1.12.2016; 2.12.2016; 27.12.2016 dhe 29.3.2017

shtetasi Xh. B., kjo nuk do të thotë që ato të jenë kryer me të ardhura të këtij shtetasi, pasi referuar përshkrimin të veprimeve bankare në të gjitha derdhjet ku përmendet emri i subjektit (në katër prej tyre është qartësisht e dukshme që pagesat janë kryer nga subjekti), si dhe rrethanave të tjera të përmendura në këtë vendim, krijohet bindja që shumat janë marrë nga subjekti i rivlerësimit. Për më tepër, pagesat me përshkrimin Xh. B. për shoqërinë “H.” sh.p.k., janë në vlerën totale prej 55.310 euro, përfaqësojnë aq sa ky shtetas ka marrë nga subjekti i rivlerësimit në vitin 2015. Logjikisht, pjesa e mbetur, për të cilën në të gjitha përshkrimet e veprimeve bankare është përmendur emri i subjektit Arben Smaçi, është paguar prej tij.

44.3. Në parashtrimet e tij, subjekti deklaroi se nuk ka qenë fare në dijeni të kontratës së sipërmarrjes ndërmjet shtetasit Xh. B. dhe subjektit “H.” sh.p.k. dhe vlerës 90.000 euro të kësaj kontrate, pasi ky akt nuk i është bashkëngjitur si dokument integral kontratës së tij. Ky pretendim është i pabazuar përderisa në kontratën premtim shitje nr. ***, datë 15.5.2015, nënshkruar nga subjekti dhe shtetasi Xh. B., në nenin 2 të saj “përshkrimi i pasurisë”, është referuar se pasuria objekt i kësaj kontrate është përfituar sipas kontratës së sipërmarrjes nr. ***, datë 15.5.2015, të lidhur midis shtetasit Xh. B. dhe shoqërisë “H.” sh.p.k., por pa u specifikuar çmimi i saj. Edhe nëse marrim të mirëqenë faktin që subjekti nuk ka qenë në dijeni të çmimit prej 90.000 euro për blerësin e parë Xh. B., ky fakt nuk justifikon blerjen e pasurisë prej tij në çmimin 50.000 euro, me një marrëveshje të lidhur në të njëjtën ditë dhe menjëherë pas kontratës së lidhur midis shoqërisë dhe blerësit të parë të saj, z. Xh. B., i cili e ka blerë pasurinë në çmimin 90.000 euro. Po kështu, deklarimi i subjektit se ka rënë në dijeni të kontratës me shtetasin Xh. B. gjatë pyetjes pranë ILDKPKI-së, mbetet në nivel deklarativ dhe i pavërtetë, pasi në procesverbalin e pyetjes në dhjetor të vitit 2015, subjekti nuk është pyetur dhe nuk ka dhënë sqarime mbi këtë rrethanë.

44.4. Subjekti ka pretenduar se vendosja e çmimit prej 90 000 euro në kontratën e sipërmarrjes me shtetasin Xh. B., është bërë për të përcaktuar çmimin për metër katror të sipërfaqes përfituese të pronarëve të truallit (një nga të cilët sipas subjektit ka qenë edhe shtetasi Xh. B.), si ndarje raportesh mes ortakëve dhe si çmim reference midis të gjithë pronarëve të truallit ku është ndërtuar ky kompleks banimi. Në vijim, subjekti deklaroi se këtë apartament Xh. B. e kishte përfituar si dividend në shoqërinë “H.” sh.p.k., megjithëse *de jure* nuk rezultonte si ortak, por kishte blerë kuota në këtë kompani që në vitin 2014 dhe duke qenë se kompania nuk kishte lekë për të shlyer dividendin i ka dhënë apartamentin. Këto pretendime të subjektit të cilat në secilin prej rasteve mbeten në nivel deklarativ, përveç se kundërshtojnë njëra-tjetrën, duken si përpjekje të subjektit për të justifikuar përcaktimin e çmimit 90.000 euro për shkak të disa të drejtave që i takonin shtetasit Xh. B.. Por, subjekti nuk ka vërtetuar asnjë marrëveshje midis këtij shtetasi dhe shoqërisë për konvertimin e dividendëve në pasuri të paluajtshme, si dhe nuk ka paraqitur ndonjë dokument që vërteton bashkëpronësinë e tij mbi truallin e godinës. Për më tepër, subjekti dhe shtetasi Xh. B., kanë deklaruar se pasi ky shtetas ka përfituar dividendë nga shoqëria, ka paguar shumën prej 90.000 euro në favor të shoqërisë, fakt i dokumentuar edhe gjatë procesit të rivlerësimit. Pra, pavarësisht çdo marrëdhënieje që shtetasi Xh. B. ka pasur me shoqërinë “H.” sh.p.k. dhe pavarësisht faktit që ky shtetas ka përfituar dividendë nga shoqëria apo ka qenë bashkëpronar i tokës ku është ndërtuar objekti, sikurse deklarohet nga subjekti, vlera e paguar prej tij si çmim për blerjen e pasurisë ka qenë 90.000 euro. Nga ana tjetër, nuk u vërtetua asnjë fakt dhe rrethanë që të justifikojë shitjen e pasurisë nga shtetasi Xh. B. te subjekti në çmimin prej 50.000 euro, brenda të njëjtës ditë që ka pranuar blerjen në çmimin 90.000 euro, duke pësuar kështu një humbje prej 40.000 eurosh. Përkundrazi, pagesat për pjesën e mbetur përtej vlerës prej 50.000 euro likuiduar prej

subjektit që në vitin 2015, në përshkrimin e të cilave përmendet emri i subjektit të rivlerësimit, janë prova që tregojnë se diferenca prej 40.000 euro është paguar nga subjekti i rivlerësimit.

44.6. Subjekti ka pretenduar se çmimi i blerjes së pasurise prej tij është 50.000 euro dhe jo 90.000 euro, pretendim i cili rezultoi tërësisht i pabazuar referuar të gjitha provave e rrethanave të përmendura në arsyetimin e këtij vendimi e që hedhin dritë mbi pagesën prej tij të shumës prej 90.000 euro. Ndërkohë, (i) kontrata e shitjes së pasurise Nr. *** Rep, Nr. *** Kol. date 08.07.2020, e cila parashikon shumën 90.000 euro si çmim të përgjithshëm të shitjes së pasurisë ndërsa vlerën 50.000 euro si shumë të likuiduar zotit B.; (ii) kartela e pasurisë në emër të subjektit dhe bashkeshortes së tij e cila pasqyron vlerën e pasurisë në shumën prej 90.000 euro dhe jo 50.000 euro, si dhe (iii) fakti që çmimi i pretenduar nga subjekti është pothuajse sa ½ e vlerës së tregut për njëmbëdhjetë apartamente të shitura në të njëjtën godinë e në të njëjtin kat me apartamentin e subjektit, vlerësohen nga Komisioni si prova të pakundërshtueshme që tregojnë se çmimi i paguar prej subjektit është 90.000 euro.

44.7. Subjekti ka kundërshtuar mënyrën e përlogaritjes së çmimit të shitjes nga ana Komisionit, sipas çmimeve reference duke pretenduar se Udhëzimi nr. 4, i Këshillit të Ministrave, të cilit Komisioni i është referuar, është i datës 30.9.2015, ndërkohë që subjekti e ka blerë apartamentin para kësaj date. Ky pretendim i subjektit nuk qëndron pasi (i) Udhëzimi Udhëzimi nr. 4, i Këshillit të Ministrave përcakton çmimet e referencës për të gjithë vitin 2015; (ii) edhe nëse do i referoheshim Udhëzimit nr. 2, datë 6.8.2014, të Këshillit të Ministrave, çmimi i referencës për metër katror për zonën e Tiranës, ku ndodhet apartamenti i subjektit, është i njëjtë me atë të Udhëzimit të përdorur nga Komisioni.

44.8. Sa i takon analizës financiare, subjekti ka pretenduar se është i pabazuar konstatimi i Komisionit në lidhje me mungesën e të ardhurave të vëllait P. S. në Mbretërinë e Bashkuar. Për të mbështetur këtë pretendim, në parashtrimet e tij, subjekti ka dhënë shpjegime të detajuara për situatën dhe punësimin e vëllait P. S., sipas të cilave, jeton në Mbretërinë e Bashkuar, me një pasaportë të lëshuar në emër të një shtetasi italian, për punën e të cilit janë paguar detyrimet ndaj shtetit anglez, dhe, për rrjedhojë, të ardhurat e tij duhet të konsiderohen të ligjshme, pavarësisht se kujt i takojnë ato. Për të mbështetur pretendimet e tij, subjekti i referohet të njëjtave dokumente që ka paraqitur në përgjigje të pyetësorit nr. 2, nga të cilat, asnjë prej tyre nuk provon të ardhura të ligjshme të vëllait P. S., me qellim justifikimin e dërgesave. Për rrjedhojë, subjekti nuk arriti të kundërshtojë barrën e provës në lidhje me burimin e ligjshëm të të ardhurave që kanë shërbyer për dërgesat e vëllait, si emigrant në Mbretërinë e Bashkuar, deklaruar prej tij në DPV.

44.9. Subjekti ka pretenduar të ardhura në natyrë të krijuara nga prindërit nga toka bujqësore që babai zotëron në Sh., Dibër, ashtu si dhe nga mbjellja dhe prodhimi i perimeve dhe pemëve të ndryshme në oborrin prej 500 m² të shtëpisë në Paskuqan, ku prindërit banojnë. Gjithashtu, subjekti ka pretenduar se babai dhe vëllezërit kanë kryer punë sezonale bujqësore në Greqi të cilat kanë shërbyer për të ndërtuar shtëpinë e prindërve, si dhe shpenzimet e kryera nga familja. Për të justifikuar të ardhurat e pa dokumentuara nga emigracioni, subjekti i referohet gabimisht ligjit për ndihmën ekonomike, i cili parashikon se nuk përfitojnë nga ky ligj familjet e shtetasve shqiptarë që banojnë jashtë shtetit ose kur njëri nga anëtarët e familjes është në emigracion duke argumentuar se: *“Sipas këtij legjislacioni dhe akteve nënligjore të nxjerra në bazë dhe për zbatim të këtij ligji, rezulton se të ardhurat e sjella nga vëllai im P. S. emigrant në shtetin grek, të sjella dorazi dhe të depozituara nga ana ime përpara se të emërohem prokuror të konsiderohen si të ardhura të ligjshme”*.

Pavarësisht çdo pretendimi, subjekti nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion për të provuar punësimin e vëllezërve apo babait jashtë shtetit, si dhe të ardhura të ligjshme të tyre nga emigracioni në Greqi apo në Mbretërinë e Bashkuar, si para fillimit të detyrës dhe në vijim, si dhe as të ardhura nga toka bujqësore, me qëllim legjitimimin e burimit të ligjshëm të pasurive përfshirë edhe depozitat e mbartura që përpara fillimit të detyrës, sipas parashikimit të pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës. Ndërkohë, pavarësisht faktit se gjatë procesit subjekti ka deklaruar se ka jetuar deri në vitin 2016 me familjen e tij të origjinës, siç është përmendur dhe më sipër në këtë vendim, në analizën financiare të subjektit për të gjitha vitet, shpenzimet e jetesës janë llogaritur vetëm për familjen e subjektit, duke mos u përfshirë as të ardhurat e anëtarëve të familjes së origjinës dhe as shpenzimet e tyre.

45. Bazuar në të gjitha faktet dhe provat e administruara gjatë procesit të rivlerësimit, sa i takon apartamentit të banimit në Tiranë, në përfundim të këtij procesi, subjekti: (i) nuk arriti të kundërshtojë barrën e provës sa i takon çmimit të blerjes së pasurisë dhe Komisioni krijoi bindjen se çmimi i paguar nga subjekti për blerjen saj është në vlerën 90.000 euro aq sa shitësi i parë i pasurisë e kishte blerë pasurinë në të njëjtën datë që ka lidhur kontratën për premtimin e shitjes me subjektin dhe po aq sa janë shitur 11 apartamente të tjerë në të njëjtin pallat. Kjo vlerë është konfirmuar edhe nga kartela e pasurisë lëshuar në emër të subjektit dhe bashkëshortes së tij. Në këto kushte, subjekti ka kryer deklaram të pasaktë dhe të rremë të çmimit të blerjes së këtij apartamenti në DPV-në e vitit 2015 dhe në deklaratën *Vetting*, (germa “a”, e pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016); (ii) nuk ka justifikuar me të ardhura të ligjshme shumë 50.000 euro, paguar deri më 8.6.2015, për shkak të një balance negative prej -4.011.101 lekësh, rezultuar nga analiza financiare deri në këtë datë, si dhe ka qenë në pamundësi financiare për të paguar diferencën prej 40.000 euro, për shkak të një balance negative prej -6.545.522 lekësh³⁵ (germa “b”, e pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016).

Të dyja këto përfundime janë të mjaftueshme për të vlerësuar se subjekti ka kryer deklaram të pasaktë e të pamjaftueshëm të pasurisë objekt shqyrtimi, sipas pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, i cili e parashikon këtë si shkak për marrjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra të subjektit të rivlerësimit.

Sa i takon konstatimit të evidentuar edhe në barrën e provës se subjekti ka kryer fshehje të pagesës prej 40.000 euro, në procesin e vlerësimit përfundimtar të çështjes, trupa gjyqësore nuk e kualifikoi mosdeklarimin e pagesës së kësaj shume si fshehje pasurie, referuar fakteve dhe rrethanave si vijojnë: (i) deklarata *Vetting* është plotësuar në datën 28.1.2017 dhe një pjesë e pagesave që përbejnë këtë shumë janë kryer pas kësaj date; (ii) blerja përfundimtare e pasurisë është bërë me akt noterial të vitit 2020 dhe objekt i veprimtarisë së Komisionit është rivlerësimi i pasurive të krijuara deri në momentin e dorëzimit të deklaratës *Vetting*; (iii) në vlerësim të të gjitha rrethanave, sa i takon kësaj shume, në përfundim, Komisioni çmoi që subjekti ka kryer deklaram të rremë të çmimit të blerjes së pasurisë, trajtuar më sipër.

46. Në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar pagesë për shkollën e vajzës si nxënëse në shkollën 9-vjeçare jopublike “T. O.”, Tiranë, në vlerën 2.595 euro. Pjesa takuese: 100%. Në përgjigje të pyetësorit standard, subjekti ka deklaruar se pagesat për shkollën e vajzës janë mundësuar nga dhurata në para të vëllait P. S.. Në DPV-në e vitit 2016 subjekti ka deklaruar se ka paguar për shkollimin e vajzës së tij

³⁵E cila përbëhet nga balanca negative prej -5.346.327 lekësh, rezultuar nga analiza e vitit 2016 dhe balanca negative -1.199.195 lekë, rezultuar nga analiza për periudhën 1.1.2017 - 29.3.2017.

shumën prej 2.595 euro për këtë vit. Ndërsa, nga verifikimi i dokumenteve të administruara nga ILDKPKI-ja³⁶ konstatohet se vajza ka ndjekur shkollën fillore jopublike “T. O. E.” sh.a. për vitin 2016 - 2017 dhe se subjekti ka paguar shumën e deklaruar prej 2.595 euro në vitin 2016, duke mbuluar të gjitha detyrimet që rrjedhin nga kontratat me këtë institucion. Por, duke qenë se nuk janë vërtetuar të ardhura të ligjshme të vëllait P. S., në Angli, kjo shumë nuk është konsideruar si e ardhur e ligjshme në analizën financiare të këtij viti.

47. Në rubrikën “Detyrime financiare” subjekti ka deklaruar: “(i) kontratë huaje pa interes me shtetasin N. F. në shumën 20.000 euro, me afat 4 vjet, me këst shlyerje në shumën e 5.000 eurove/vit. Kjo hua është marrë për pagesën e kontratës së premtim blerjes së apartamentit në Tiranë. Shuma e detyrimit të mbetur 15.000 euro, trajtuar më sipër; (ii) kredi e marrë në ‘Raiffeisen Bank’ (overdraft,) në shumën 200.000 lekë, ku unë kam tërhequr nga overdrafti im dhe rezulton debitor në shumën 120.410 lekë, pasi pjesa tjetër është gjendje në llogari, e përfituar nga paga, të cilën e mban banka automatikisht. Shuma e detyrimit të mbetur 120.410 lekë”.

Nga verifikimi i lëvizjeve të llogarisë së pagës në “Raiffeisen Bank” rezultoi se deklaramet e subjektit përputhen me të dhënat bankare.

48. Personi i lidhur, bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit, znj. E. S., ka plotësuar autorizimin për kontrollin e deklaratës së interesave, ku ka evidentuar që nuk ka pasuri veçmas të regjistruar në emrin e saj. Nga verifikimet e kryera nuk rezultoi të ketë pasuri veçmas në emër të znj. E. S..

49. Përveç verifikimit të deklarameteve të subjektit dhe personave të lidhur me të në deklaratën *Vetting*, Komisioni kreu hetime në lidhje me konstatimet si vijojnë:

49.1. Nga të dhënat e administruara nga FSHU-ja³⁷ rezultoi se në emër të subjektit të rivlerësimit, përveç kontratës së furnizimit me energji elektrike në apartamentin në pronësi të tij në rrugën “N. M.” Tiranë, ka edhe një kontratë furnizimi me nr. *** në instancën Lezhë. Gjatë hetimit administrativ, i pyetur në lidhje me këtë kontratë, subjekti mohoi të ketë pasuri pasuri në pronësi apo në përdorim që i përkasin kësaj kontrate³⁸. Për të vërtetuar pretendimet e tij, ka paraqitur shkresë kthim përgjigje nr. *** Prot, dt.24.05.2021 nga OSHEE-ja, sipas së cilës kontrata e furnizimit me energji me nr. ***, i përket shtetasit Arben N. Smaçi. Po kështu, ASHK-ja Lezhë³⁹ informoi se subjekti i rivlerësimit, bashkëshortja dhe prindërit e tij nuk kanë pasuri të paluajtshme në Lezhë.

49.2. Në DPV-në e vitit 2016 dhe në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar dy adresa të ndryshme të regjistrimit në Gjendje Civile, adresën “Njësia Bashkiake Nr. *** rruga: ‘N. M.’, p. M., ap. ***, Tiranë” dhe adresën “Nj. Administrative Nr. 7, rruga ‘A. L.’, kompleksi ‘M.’, obj. ‘O.’, ap. ***, Bashkia Tiranë”. I pyetur mbi këto adresa, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti deklaroi se janë e njëjta adresë dhe se rruga “N. M.” është emërtuar rruga “A. L.” në vitin 2017, duke e vërtetuar këtë pretendim me dokumentin e lëshuar nga OSHEE-ja sipas të cilit subjekti njoftohet për adresën e tij të re, në rrugën “A. L.”, nd. ***, h. ***, ap. ***, Njësia Administrative Nr.7, ***, Tiranë.

³⁶Shihni aneksin 4/6 të ILDKPKI-së.

³⁷Shihni shkresën nr. *** prot., datë 21.1.2021, të FSHU-së në dosjen e Komisionit.

³⁸Shihni përgjigjet dhe dokumentacionin bashkëngjitur përgjigjeve të pyetësorit nr. 2, në dosjen e Komisionit.

³⁹Shihni shkresë kthim përgjigje nr. *** prot., datë 29.1.2021, nga ASHK-ja Lezhë në dosjen e Komisionit.

49.3. Në përgjigje të pyetësorit standard, subjekti ka deklaruar se në tetor të vitit 2009 (para fillimit të detyrës datë 15.10.2010), së bashku me bashkëshorten, prindërit dhe vëllezërit janë zhvendosur nga Dibra për të jetuar në Tiranë në adresën rruga “A. Xh.”, Njësia Administrative Paskuqan, Bashkia Kamëz, Tiranë, kur ka nisur të jetojë në apartamentin në rrugën “N. M.”, Tiranë. Sipas deklarimit të subjektit, kjo banesë është një shtëpi dykatëshe e ndërtuar rreth viteve 2000⁴⁰ - 2005 me kontribute të babait (emigrant ilegal në Greqi në periudhën 1993 – 2003) dhe të vëllait P. S. (emigrant ilegal në Greqi dhe Angli). Në lidhje me këtë banesë, subjekti ka paraqitur disa dokumente shkresore, midis të tjerave: (i) certifikatë pronësie, nr. ***, lëshuar më 23.10.2019, sipas së cilës pasuria nr. ***, e llojit truall me sip. 500.5 m², në Kamëz, është e regjistruar në emër të shtetasit A. S.; (ii) leje legalizimi, datë 22.5.2019, dhënë shtetasit A. S. për godinën e banimit 2 kate në Paskuqan, Kamëz, pasuria nr. ***, me sip. parcele 500.5 m² dhe sip. ndërtimi 126 m². Trualli i pronësisë mbi tokën, dhënë sipas VKM-së nr.100, datë 27.1.2009; (iii) shkresë kthim përgjigje ASHK Drejtoria Vendore Kamëz, datë 20.8.2019, drejtuar z. A. S., sipas së cilës procedura e regjistrimit do të bëhet pas regjistrimit fillestar të zonës. Ndërsa, gjatë hetimit administrativ, ASHK Kamëz-Vorë⁴¹ ka konfirmuar të regjistruar në pronësi të shtetasit A. S., pasurinë nr. ***, z. k. ***, e llojit truall me sip. 500.5 m², duke referuar lejen e legalizimit, datë 22.5.2019, godinë banimi 2 kate (sip. kati përdhe 126 m², sip. kati i parë 142.4 m²). Kjo ASHK ka informuar gjithashtu se z. A. S. është aplikues në procesin e legalizimit, duke bërë vetëdeklarimin nr. *** prot., datë 6.2.2006, dosje e cila është e paplotësuar dhe e patrajtuar. Në përfundim të hetimit administrativ nuk rezultuan lidhje të subjektit të rivlerësimit me këtë pasuri, e cila është krijuar përpara se subjekti i rivlerësimit të niste detyrën e prokurorit.

49.4. Gjatë hetimit administrativ është evidentuar se subjekti ka deklaruar se ka banuar në Tiranë, ndërkohë që ka punuar 1 vit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës dhe nga data 15.11.2011 deri në deklaratën *Vetting* ka punuar në Prokurorinë pranë Gjykatës Rrethit Gjyqësor Shkodër. Pasi është pyetur nëse ka pasur shpenzime qiraje, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka deklaruar se nuk ka pasur një shpenzim të tillë dhe se e ka bërë rrugën vajtje-ardhje, çdo ditë, nga vendbanimi në vendin e punës. Në lidhje me shpenzimet e transportit subjekti ka dhënë sqarime të detajuara dhe shpenzimet e transportit janë përfshirë në analizën financiare, në periudhat përkatëse.

49.5. Nga të dhënat e administruara nga DPSHTRR-ja⁴² rezultoi që subjekti dhe personat e tjerë të lidhur me të nuk kanë automjete të regjistruara në pronësi të tyre.

49.6. Nga të dhënat e regjistrimit noterial⁴³, në emër të subjektit të rivlerësimit apo bashkëshortes, nuk rezultuan akte noteriale të tjera nga ato të deklaruara prej tij.

49.7. Nga të dhënat e hyrje-daljeve në sistemin *TIMS* rezulton se subjekti ka udhëtuar, ndër të tjerash, edhe me automjetin me targa ***. I pyetur mbi pronarin e këtij automjeti, marrëdhënien me të dhe qëllimin e udhëtimit, subjekti sqaroi se⁴⁴ me këtë automjet kishte udhëtuar në datën 1.6.2015 nga Greqia në drejtim të Shqipërisë. Në datën 29.5.2015 kishte udhëtuar me autobus me kolektivin e punës për në Greqi, ku kishte qëndruar për disa ditë te daja e tij në V.. Kur është kthyer nëpërmjet pikës

⁴⁰Në procesverbalin datë 22.12.2015 pranë ILDKPKI-së, deklaroi si fillim të ndërtimit vitin 1999 (përgjigje nr. 2).

⁴¹Shihni shkresat kthim përgjigje: nr. *** prot., datë 4.2.2021 nga ASHK Kamëz Vorë dhe nr. *** prot., datë 5.2.2021 nga ASHK Kamëz Vorë, në dosjen e Komisionit.

⁴²Shihni shkresën kthim përgjigje nr. *** prot., datë 18.1.2021 nga DPSHTRR-ja në dosjen e Komisionit.

⁴³Shihni shkresën kthim përgjigje nr.*** prot., datë 20.1.2021, nga Ministria e Drejtësisë në dosjen e Komisionit.

⁴⁴Shihni përgjigjet e subjektit dërguar në rrugë elektronike në datën 9.6.2021, në dosjen e Komisionit.

kufitare të Kapshticës, pa kolektivin, për shkak se nuk kishte gjetur autobus ishte kthyer me këtë automjet. Subjekti deklaron se pronarin e automjetit nuk e njihje, por nga informacionet e marra nga Drejtoria e Kufirit dhe Migracionit Shkodër ishte informuar se shofer i këtij automjeti ishte shtetasi B. Xh. L., për të cilin deklaron me përgjegjësi të plotë se nuk ka asnjë lidhje dhe se gjatë gjithë periudhës që ka ushtruar detyrën e prokurorit nuk ka hetuar dhe nuk ka trajtuar ndonjë procedim penal me këtë shtetas. Subjekti ka paraqitur: (i) shkresë kthim përgjigje nr. *** prot., datë 9.6.2021 nga Drejtoria vendore për Kufirin dhe Migracionin Shkodër, shoqëruar nga hyrje-daljet në sistemin *TIMS* të këtij shtetasi.

Analiza financiare për të gjithë periudhën e rivlerësimit

50. Në përfundim të hetimit administrativ, Komisioni ka kryer analizën financiare për të gjithë periudhën e rivlerësimit, bazuar në vlerën e pasurive, të ardhurat dhe shpenzimet e kryera përgjatë çdo viti, pasqyruar në mënyrë të përmbledhur në tabelën më poshtë, analizë e cila nuk ndryshoi deri në momentin e vlerësimit përfundimtar të çështjes edhe pasi subjekti ushtroi të drejtën e barrës së provës, për shkaqe të arsyetuara në këtë vendim. Sipas kësaj analize, totali i balancave negative është në shumën 7.320.920 lekë.

	1	2	3	4	5	6
Përshkrimi	Pasuri	Detyrime	Pasuri <i>neto</i> (1-2)	Të ardhura	Shpenzime	Mundësia për kursime (4-5-3)
2010	20 819	-	20 819	192 682	90 612	81 252
2011	33 324	-	33 324	764 099	503 706	227 069
2012	354 034	-	354 034	1 063 935	636 452	73 450
2013	125 660	-	125 660	995 561	593 096	276 806
2014	663 683	-	663 683	1 320 219	850 767	-194 230
2015	4 695 621	2 745 600	1 950 021	1 460 825	1 291 165	-1 780 362
2016	4 021 828	-676 150	4 697 978	1 183 137	1 831 487	-5 346 327

51. Metodologjia e përdorur gjatë analizës financiare

Në analizën financiare, për çdo pasuri të krijuar dhe/ose shpenzim të kryer, është analizuar mundësia financiare e subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të, duke krahasuar në çdo rast informacionet e marra në rrugë zyrtare nga institucionet kompetente ligjore me deklaratimet e subjektit. Kjo analizë është kryer duke marrë në konsideratë:

51.1. Të ardhurat

- Të ardhurat e dokumentuara nga punësimi të subjektit nga nëntori i vitit 2001, kohë kur subjekti ka përfiturar të ardhura që i ka përdorur si burim për pasuri të krijuara pas emërimit në detyrë dhe deri në fund të periudhës së vlerësimit⁴⁵.

⁴⁵Shihni vërtetimet e pagave të subjektit në aneksin 4/5 në dosjen e administruar nga ILDKPKI-ja.

- Të ardhurat nga interesat bankare të përfituara gjatë investimit të depozitave në bankat e nivelit të dytë⁴⁶.

51.2. Shpenzimet

- Shpenzimet e jetesës janë përlllogaritur, bazuar në standardin e ILDKPKI-së dhe përbërjes familjare të subjektit e cila ka qenë si vijon: nëntor 2001 – 2008 një person; viti 2009 – 28.10.2010 për dy persona; datë 28.10.2010 deri në fund të vitit 2014 për tre persona dhe për vitet 2015 dhe 2016 për katër persona.

- Shpenzime për kopshtin dhe shkollën e vajzës⁴⁷.

- Shpenzimet e udhëtimit janë bazuar në raportin e sistemit *TIMS* dhe në sqarimet e dhëna nga subjekti gjatë procesit të hetimit administrativ. Metodologjia e përlllogaritjes së këtyre shpenzimeve është ajo e përcaktuar në vendimin (JR) nr. 11, datë 22.5.2019, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

- Shpenzimet e transportit nga vendbanimi në vendin e punës janë përlllogaritur bazuar në deklaratimet e subjektit në përgjigjet e pyetësorit nr. 2, në të cilin ka sqaruar se gjatë gjithë detyrës së tij ka kryer rrugën vajtje-ardhje, çdo ditë, nga banesa në punë dhe anasjellas.

- Për periudhën tetor 2010 – nëntor 2011, subjekti ka udhëtuar në destinacionin Tiranë-Durrës-Tiranë me mjete të transportit publik. Për të përlllogaritur shpenzimet e udhëtimit 1 muaj është konsideruar me 22 ditë pune dhe çmimi i biletës 300 lekë.

- Për periudhën nëntor 2011 deri në fund të vitit 2016 ka udhëtuar në destinacionin Tiranë-Shkodër-Tiranë me tre kolegë të tjerë, me automjetin e njërit prej tyre, dhe se shpenzimet janë ndarë midis katër personave. Për të përlllogaritur shpenzimet e udhëtimit 1 muaj është konsideruar me 22 ditë pune dhe kostoja e një udhëtimi: distanca x 7 litra/100 km x çmimin e karburantit.

- Shpenzimet e mobilimit janë përfshirë bazuar në përgjigjet e pyetësorit nr. 2.

- Çdo shpenzim tjetër sikurse është evidentuar nga lëvizjet bankare.

51.3. Pasuritë

- Është përfshirë pasuria apartament në pronësi të subjektit, blerë në vitin 2015.

- Janë përfshirë likuiditetet sipas gjendjeve të llogarive bankare⁴⁸ në fund të çdo viti dhe date të analizuar. Analiza e likuiditeteve është kryer edhe për periudha para emërimit në detyrë të subjektit, pasi një pjesë e depozitave të përdorura si burim për pasurinë apartament të blerë në vitin 2015 janë krijuar para fillimit të detyrës.

- Ndryshimi i likuiditeteve dhe pakësimi ose shtesa nga viti në vit është pasuria e krijuar nga subjekti për çdo vit.

⁴⁶ Shkresat: nr. *** prot., datë 19.1.2021, nga "Raiffeisen Bank" dhe nr.*** prot., datë 11.2.2021, nga BKT-ja.

⁴⁷Kontratë nr. ***, datë 25.5.2016 me shkollën jopublike "T. O".

⁴⁸Shihni shkresat nga bankat, të administruara në dosjen e Komisionit: nr. *** prot., datë 19.1.2021 nga "Raiffeisen Bank" dhe nr.*** prot., datë 11.2.2021, nga BKT-ja.

- Vlera e apartamentit është marrë nga kontratat e porosisë dhe të shitblerjes, si dhe bazuar në pagesat e kryera në “Union Bank”⁴⁹ nga shitësi në emër të subjektit, për vitin 2016 dhe për intervalin kohor janar-mars 2017.

- Shuma në fund përbën totalin e pasurisë së akumuluar nga subjekti nga fillimi i detyrës deri në fund të periudhës së vlerësimit.

51.4. Detyrimet

- Huaja e marrë⁵⁰ nga individë/të tretë dhe shlyerja e saj sipas deklarimeve të subjektit.

- Pasuria *neto* është diferenca e pasurisë me detyrimet.

Rezultati financiar është i përllogaritur për çdo vit, për çdo datë/periudhë të krijimit të pasurisë/ve, si dhe në total.

Mundësia për kursime rezulton si shumatore e të ardhurave (shpenzime + pasuri *neto*) për çdo vit dhe për të gjithë periudhën e rivlerësimit.

IV. SEANCA DËGJIMORE

Në datat 8.7.2021 dhe 15.7.2021, sipas nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Francesco Ciardi, u zhvilluan seancat dëgjimore për procedurën e rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit, z. Arben Smaçi, i cili në përfundim kërkoi konfirmimin në detyrë. Gjatë seancës së dytë dëgjimore, subjekti i rivlerësimit, personalisht ose nëpërmjet përfaqësueses ligjore, shprehu qëndrimin e tij, duke dhënë sqarime të mëtejshme mbi rezultatet e hetimit administrativ, procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij dhe duke iu përgjigjur pyetjeve të drejtuara nga anëtarët e trupit gjykues. Deklarimet e subjektit dhe përgjigjet e tij në këtë seancë u vlerësuan nga Komisioni në raport me të gjitha provat e tjera të administruara gjatë procesit të rivlerësimit dhe të gjitha së bashku krijuan bindjen se ndaj subjektit duhet të merrej masa disiplinore e shkarkimit nga detyra. Në datën 21.7.2021 u zhvillua seanca në të cilën Komisioni shpalli vendimin për shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Arben Smaçi.

V. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

Gjatë procesit të rivlerësimit, sipas nenit 46 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave, si dhe krijimin e bindjes së brendshme, trupi gjykues ka komunikuar me anë të postës elektronike me subjektin e rivlerësimit. Në komunikimet e tij, subjekti ka qenë, përgjithësisht, korrekt e i gatshëm me dërgimin e shpjegimeve dhe dokumenteve të kërkuara, por, është konstatuar se i ka kërkuar Komisionit disa herë shtyrje të afatit të kthimit të përgjigjeve të pyetësorëve, paraqitjes së provave dhe parashtrimeve mbi rezultatet e hetimit, si dhe dy herë ka kërkuar shtyrje të datës së seancës dëgjimore të caktuar nga Komisioni. Pavarësisht se Komisioni i ka pranuar në çdo rast kërkesat e subjektit, ka vlerësuar se ato më së shumti janë paraqitur jo gjithmonë të justifikuara objektivisht në

⁴⁹Shihni lëvizjet bankare të shoqërisë “H.” sh.p.k., sjellë Komisionit në rrugë elektronike.

⁵⁰Shihni dokumentet në aneksin 4/9 në dosjen e administruar nga ILDKPKI-ja.

limit të afateve të përcaktuara, duke sjellë vonesa dhe zvarritje të cilat duhet të shmangeshin nga subjekti i rivlerësimit.

KONKLuzion Përfundimtar

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, gjatë bisedimeve për vlerësimin përfundimtar të çështjes, bazuar në provat e administruara gjatë procesit të rivlerësimit, si dhe në qëndrimin e subjektit të rivlerësimit për çdo çështje, rast pas rasti, arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, z. Arben Smaçi, nuk arin nivelin kualifikues për sa i takon kriterit të pasurisë, pasi ka kryer deklarime të pasakta dhe të pamjaftueshme, sipas nenit 61/3 të ligjit nr. 84/2016, çka përbën shkak për marrjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra. Vendimmarrja për këtë subjekt u vlerësua të bazohet vetëm në përfundimet e arritura në lidhje me kriterin e pasurisë, sipas parashikimit të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u mbledh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, sipas parashikimit të pikës 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, bazuar në germën “c”, të pikës 1, të nenit 58 dhe në pikën 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

V E N D O S I:

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Arben Smaçi, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.
2. Vendimi, i arsytuar me shkrim, i njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore 64 dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjektet e interesuara brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 21.7.2021.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Valbona SANXHAKTARI
Kryesuese

Firdes SHULI
Relatore

Olsi KOMICI
Anëtar

Sekretare gjyqësore
Orianda Liçi

